

*"Burimi i vërtetë i të drejtave tona është detyra" - GANDI*



# Dukagjini

**Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XII i botimit, nr. 137, mars 2015**

Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355692465784, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktor: Luigj Shyti, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

## TË LËVIZIM ZGJEDHJET PO VINË

**"TASH ËSHTË KOHA ME MBJELLË QEPË ..."**

Kohë më parë, në një lagje të një fshati malor, ishte një burrë në moshë të mesme me emrin Kolë, që jetonte vetëm me gruan e tij. Punonin tokën dhe, veçanërisht, qepët i bëheshin shumë të mira. Kjo sepse i mbilte në kohën e duhur dhe tregonte shumë kujdes që në fillim të punës. Qepët e tij jetonin shumë. Në dimër shkonin banorë nga lagja dhe bënin si bënin e i kërkonin qepë. Kjo vazhdoi të përsëritej në vite. Pasi e pa se po bëhej rrugë që nuk mund ta përballonte, një ditë pranverë, tamam kur kishte ardhur koha për të mbjellë qepët del rrugës përmes lagjes dhe fliste me zë të lartë, në mënyrë që të dëgjonin të gjithë: "tash është koha më mbjellë qepë". Vitet kanë kaluar, edhe sot përmendet kjo shprehje, e cila ka të bëjë me kryerjen e punëve në kohën e duhur.


2

**Në prag të 100 vjetorit të vrasjes**

## MEHMET SHPENDI KËRKONDE LIRINË

Gati 100 vjet më parë u vra nga ushtria pushtuese e Malit të Zi, në pabesi atdhetari Mehmet Shpendi, Çun Nika, Marash Delia dhe dhjetra burra e gra, nga Pulti, Shala dhe më gjerë, në Plan të Pultit.

Në kuadrin e këtij përvjetori po botojmë një letër të atdhetarit Mehmet Shpendit, gjetur, përkthyer dhe pajisur me shënime nga studiuesi Pal Doçi, publikuar, për herë të parë, në shtypin e kohës, në vitin 1971. Prijësi i Djelmnisë së Shalës, Mehmet Shpendi, këtë letër i a dërgonte "Komitetit për Shqipërinë" me qendër në Romë, vetëm 6 ditë përpara se të fillonte kryengritja në Shqipërinë e Veriut. Kjo letër hell dritë mbi disa çështje të rëndësishme të kësaj kryengritje. Letra i ishte dërguar N. Ivanajt, i cili aso kohe ndodhej në Romë dhe përpqej për të mbledhur ndihma për kryengritjen, për ti a dorëzuar atij komiteti. Ky Komitet nuk qe i angazhuar si duhet në këtë drejtim, megjithëse Mehmet Shpendi dhe ndjekësit e tij kishin shpallur hapur se ishin për luftë armë në dorë kundër pushtuesve.



3

## MARTIN CAMAJ, METEOR QË NUK SHUHËT



Martini Camaj u lind në Telumë të Temalit në Dukagjini, më 13 korrik 1925 në vendin e quajtur. I biri i Kolë Camës, dhe Terezës. Nëna Terezë ishte nga Prekali, u lind i pari ndër shtatë fëmijë. Vendlindja e tij ishte, sipas vetë Martinut, "... në një vis të egër, 'ku s'ka shkelë kurrë kamba e kalit', kaq i thyeshëm ashtë ky vend". Martini, në vendlindje do të kalojë dhjetë vitet e para të jetës së tij. Nis të fitojë në mënyrë autodidakte njohuritë e para në shkrim e lexim shqip dhe matematikë. Kjo gjë do t'i binte në sy ish-pagëzuesit P. David Pepës OFM, duke e nxitur që të ndërmjetësojë pranë instancave eprore në Shkodër që të bënin të mundur për për arsimimin dhe përgatitjen, pse jo, për meshtari.

Në vitin 1935 vendoset përfundimisht në Shkodër dhe fillon të marrë arsim të rregullt pranë kolegjit jezuit "Xaverianum", ku do kalonte edhe sëmundjen e tuberkulozit. Rector i kolegjit në atë kohë qe P. Giuseppe Valentini SJ, prej të cilit mësojmë fillor 5 vjeçar...

4

## VATIKANI DHE SHQIPTARËI

**ME DATEN 7 MARS 2015, NE MJEDET E HOTEL INTERNATIONAL SALLA "BALSHA" U ZHVILLUA CEREMONIA E PROMOVIMIT TË LIBRIT "VATIKANI DHE SHQIPTARËI", BOTIM I SENATIT DEMOKRISTIAN, NË PRANI TË DHJETRA INTELEKTUALEVE, STUDIUESVE, SHKRIMTARËVE, KLERIKËVE, AMBASADORËVE DHE POLITIKANËVE.**

6

## SHUMËSPORTSHI "VLLAZNIA", KLUB I SUKSESEVE DHE GJITHË PËRFSHIRJES

Shkodra ky qytet i lashtë, me emër të madhe në histori, ka bërë jehonë e krijuar traditë edhe në sport, duke u bërë kështu pjesë e pandare e jetës dhe aktivitetit të Tij. Po fole për Shkodrën në mote dhe nuk the gjë për kulturën e sportin, në jetën e tij, zëre se nuk ke thënë gjë. Këto dy aktivitete të shoqërisë e komunitetit shkodran, i kane dhënë hijeshinë jetës në Shkodër.

10

# TË LËVIZIM ZGJEDHJET PO VINË



Nga Luigj Shyty

## “TASH ËSHTË KOHA ME MBJELLË QEPË ...”

Kohë më parë, në një lagje të një fshati malor, ishte një burrë në moshë të mesme me emrin Kolë, që jetonte vetëm me gruan e tij. Punonin tokën dhe, veçanërisht, qepët i bëheshin shumë të mira. Kjo sepse i mbillte në kohën e duhur dhe tregonte shumë kujdes që në fillim të punës. Qepët e tij jetonin shumë. Në dimër shkollonin banorë nga lagja dhe bënin si bënin e i kërkonin qepë. Kjo vazhdoi të përsëritej në vite. Pasi e pa se po bëhej rrugë që nuk mund ta përballonte, një ditë pranverë, tamam kur kishte ardhur koha për të mbjellë qepët del rrugës përmes lagjes dhe fliste me zë të lartë, në mënyrë që të dëgjonin të gjithë: “tash është koha më mbjellë qepë”. Vitet kanë kaluar, edhe sot përmendet kjo shprehje, e cila ka të bëjë me kryerjen e punëve në kohën e duhur.

Zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore janë në prag. Është koha që njerëzit të bëhen të gjallë, të duken atje ku është vendi dhe koha. Nuk ka pse të thuhet pas zgjedhjeve se nuk u bë gjë, na nëpërkëmbën, pse nuk na vlerësuan, pse nuk u kush vlerësohet për atë që bën, për atë që thotë, pra për punën, sa ai vlerëson veten dhe të tjerët. Nuk ka pse të qahet askush kur të mbarojnë punë. Titulli, grada, vlerësimi, karrigeje nuk të vjen në shtëpi asnjëherë dhe askujt. Ato duhet të kërkohen, duhet të publikohen planet dhe programet, ekipi me të cilin mendon që të drejtohet dhe punohet, objektivat që do të arrihen dhe grafiku i realizimit të tyre. Tash është koha që të mbledhim që të korrim kur të vijë koha.

Krahina e Dukagjinit ka shumë mundësi që të për-

faqësohet denjësisht, sepse ka intelektual, burra dhe gra me shkollë dhe të zgjuar, që dinë të drejtojnë dhe të menaxhojnë punët e komunitetit, ka bashkëpunues, tolerant, organizator të aftë dhe të vendosur në realizimin e objektivave.

Çdo njeri që mendon të marrë përsipër detyrën e drejtimit të një pune, të një veprimtarie, është e domosdoshme që të prijën dhe publikojnë rrugën që i duhet të bëjnë në arritjen e qëllimit. Që të mos jemi jashtë koha në 21 qershor, sot është e domosdoshme që të dalin në rreshtat e parë ata që e mendojnë veten të aftë, “tash është koha me mbjellë qepë”. Por, kjo nuk duhet të mbetet vetëm në dëshirën e atyre që vetëm duan, por edhe atyre që dinë, kuptojnë dhe mendojnë për atë që duhet. Nuk mjafton vetëm dëshira për të qenë në krye, por edhe mundësia për të qenë i duhuri për një komunitet, një territor një krahinë, një bashki. Drejtuesit kryesor po përvijohen, po i përvijojnë partitë politike. Është në të mirë të komunitetit që më të mirët dhe më të mundurit, të mos rrinë në hije e të presin se mos u vjen fati te dera. Komuniteti, populli, duan që të drejtohen dhe organizohen. Partitë politike bëjnë punën e tyre siç e mendojnë ato, por populli nuk duhet tu bindet symbydhrazi atyre. Komuniteti duhet të influencojnë, edhe për faktin se partitë përbëhen nga pjesëtarë të komunitetit.

Trimëria pas lufte dhe urtia pas kuvendit nuk kanë vlerë

Populli dhe si e tillë edhe komuniteti ynë ka nevojë që të përfaqësohet, pse jo edhe në nivelet më të larta. Intelektualët duhet të bëhen të gjallë sot, dhe jo të diskutojnë, grindemi, zihemi pas votimeve (me 22 qershor).

Zgjedhësit, votuesit nuk duhet të pranojnë që të futen në xhepin e asnjë politikani, kandidatit. Duhet të jenë të pavarur, të jenë të lirë që vërtetë të bëhen zgjedhje dhe jo zgjidhje. Kandidatët premtojnë shumë, madje “mund të premtojnë urë edhe atje ku nuk ka lumë”. Këto dhe të tilla nuk duhet pranuar. Të tillë kandidat kanë si qëllim të vetëm që të fitojnë. Domosdoshmërisht duhet kuptuar, sado që është mjaftë e vështirë, ata që rëndin pas karriges për të mirën të komunitetit nga ata që kanë qëllim të vetëm marrjen e karriges.

Reforma administrative

është shumë e rëndësishme dhe do të sjellë vetëm të mira për komunitetin, gjithmonë në qoftë se mendohet dhe punohet në shërbim të komunitetit. Sot jemi para faktit të kryer. Komuniteti dukagjinas është mjaftë i shpërndarë, por një gjë duhet ta kemi të qartë se votat do të mbledhen në një “thes” nga Thethi në bregdetin e Velipojës. Pra, kjo votë maksimalizohet, prandaj duhet bërë shumë kujdes. Është koha që të kërkojmë, ndërhyjmë dhe të llojmë pranë partive politike, veçanërisht atyre që kanë mundësinë më të madhe për fitore, që të përfaqësohemi, në mënyrë të vendosur dhe demokratike. Tash duhet të dëgjohet zëri i komunitetit, tash duhet të dëgjohet zëri i atyre që e mendojnë veten në rolin e liderit. Pas zgjedhjeve nuk ka më fjalë, se përse nuk u përfaqësuam. Të mendojmë për të ardhmen tonë dhe të fëmijëve tonë. Jo radhë dëgjohe mendime, ndërsa jemi duke pirë ndonjë kafe, pse nuk doli kjo apo ky kryetar, anëtar, drejtues, etj. Ata mund të jenë shumë të mirë, por, kur nuk bëhen të gjadhë kush i ka fajet. E përmendëm edhe më parë se nuk të vjen fati, karrigeje, grada te dera vetë. Ajo duhet kërkuar, natyrisht me punë, duhet lëvizur, duhet publikuar mendimet dhe programet

## MOS RRI PA VOTUAR, O VËLLA, O MIK...

Komuniteti, populli është duhet të jetë i vendosur që të marrin pjesë në votime. I vetmi veprim në demokraci për të ndryshuar gjendjen është vota. Dëgjohe zëra jo radhë se “unë nuk votoj sepse shkon diku tjetër dhe jo për ku e nisë unë”, “ky nuk më pëlqen, por as ai tjetri”, etj. Ka shumë raste të tilla, ose të paktën kështu thuhet apo duket. Përsëri votuesit nuk janë pa faj, sepse vërtetë duhet zgjedhë dikush, por atë që është më i miri, më i afti. Duhet kërkuar dhe siguruar se vota do të shkojë atje për ku niset. Gjithsesi të gjithë duhet të marrin pjesë në votime, si e vetmja rrugë demokratike për të bërë ndryshimin për të ecur përpara.

Nuk themi që në këshillin bashkiak të flitet vetëm më një gojë, të flitet vetëm për një zonë apo krahinë, por të shtrohen probleme që kanë të bëjnë me shqetësimet për këta njerëz dhe këto vende, për zhvillimin dhe përparimin e tyre, për mos

shkretimin e maleve dhe zone rurale, për përmirësimin e infrastrukturës, për ngritjen më lart të arsimit e kulturës që lënë për të dëshiruar, për përmirësimin e shërbimit shëndetësor, për ndërtim rrugësh dhe urash, për ujë, për drita, për turizmin aq të kërkuar dhe aq të mundshëm, për zbulimin, evidentimin, publikimin dhe ruajtjen e vlerave historike, arkeologjike, etnografike e folklorike nuk është vetëm dëshirë, por është domosdoshmëri, është detyrë, n.q.s. duam të ecim me hapin e kohës.

## MOS E SHIT VOTËN, O VËLLA, O MIK...

“Ku është më za nuk është pa gja”, thotë populli. Është folur dhe rifolur se ka pasur vota që janë shitur apo blerë. Sa vlerë ka një votë e tillë. Kjo nuk asnjë vlerë, nuk ndihmon të mirin, të përparuarin të pa korruptuarin. Përkundrazi shkon në “thesin” e atij që nuk e meriton, shkon tek i paafiti, te i korruptuari, shkon te i prapambeturi i cili nuk e ka mendjen për përmirësimin e jetës së komunitetit, por vetëm interesat personale, nepotizmin, grupazhin, përfitimin në rrugë të padrejtë. Nuk ka se si të jenë ndryshe kur shikon se ka te tillë që përdridhen si krimbi, lahen e lyhen përpara komunitetit, zvarriten deri në tokë, herë bëjnë “heroin” dhe herë bëjnë “viktimën”, shtrëjnë paranë, nuk lënë gurë pa luajtur deri sa të marrin votën. Pas votimeve, pas fitores nuk bie më telefoni, madje edhe ndërrohet numri që të mos e shqetësojnë votuesit. Zgjedhësit, qytetarët, votuesit nuk duhet të pranojnë që të futen në xhepin e asnjë politikani, apo partie a kandidati. Duhet të jenë të pavarur, të jenë të lirë që vërtetë të zgjedhin.

Shitja e votës ta mbyllë gojën. Nuk të len ti kërkosh llogari të votuarit, sepse të ka “paguar” për punën që i ke bërë. Kjo është parë edhe deri tash. N.q.s. e ke të tepërt, fale më mirë se sa ta shesësh, edhe kjo është keq por të paktën e ke gojën dhe të drejtën për të kërkuar më të lirë.

Shitja e votës është shërbimi më i keq që mund ti bëhet demokracisë.

## INTEGRIMI NË JETËN E RE ËSHTË DOMOSDOSHMËRI. Zgjedhjet vendore të këtij

viti janë disi të veçanta në tërë territorin e Shqipërisë. Janë bërë bashkime shumë të rëndësishme. Ndarja nuk qahet më, por duhet bërë të gjitha përpjekjet që ti përshtatemi kësaj kohe. Sot maksimalizohet vota për të gjithë banorët që përfshihen në Bashkinë e Shkodrës, që nga Alpet e deri në Velipojë. Përshtatja me kushtet e reja ka rëndësi sepse ndihmon në integrimin e përgjithshëm në jetën politiko-shoqërore dhe ekonomike.

Komuniteti dukagjinas edhe në kushtet e reja të organizimit territorial duhet dhe do të dijë tu përshtatet kohëve të reja, ka tradita të mira dhe duhet ruajtur, do të respektohet miku, do t'i japim vendin që i takon secilit, do të përpiqemi që mikun ta nxjerrim nga shtëpia më të mirë se erdhi.

Ne nuk mund të bëhemi të besueshëm duke respektuar të tjerët tej mase dhe duke shtyrë njëri-tjetrin. Kur është rasti ne duhet të tregojmë respektin, vendosmërinë, kulturën, e dashurinë për njëri-tjetrin, por duhet të dimë se edhe rasti nuk vjen kur të duam dhe si të duam ne, ai është i radhë, është i veçantë prandaj quhet i tillë. Kur e ke zogun në dorë nuk duhet lëshuar sepse ikën.

Është koha që të kuptojmë se politika, veçanërisht për çështje të rëndësishme, nuk duhet të na ndajë e aq më tepër kur kemi të bëjmë me njeri tjetrin sepse jemi të një gjaku, të një brumi, sepse kemi doke e zakone, tradita e gjuhë të njëjtë. Ne jemi një, e një duhet të qëndrojmë se kështu ndjehemi më mirë dhe më të mirë e nga kjo nuk duhet të kemi frikë, të lidhur me njeri-tjetrin përballojmë vështirësitë e integritit, i duhemi më shumë fshatit, krahinës, qytetit, shtetit, atdheut.

Zgjedhjet administrative janë shumë të rëndësishme. Pjesëmarrja dhe votimi pa presione partiake apo personale është e domosdoshme.

Ne nuk duhet të qëndrojmë të ftohur me njëri tjetrin për hir të partive të cilat ndërrohen, nuk duhet të veprojmë sipas asaj shprehjes së një plake që thoshte “për inat të s’ime re djalim tim e shtisha n’dhë”, duhet të kemi besim të njeri tjetri, besimi është reciprok, sepse duke vlerësuar dhe besuar njëri tjetrit do të besojnë edhe të tjerët.



## Në prag të 100 vjetorit të vrasjes **MEHMET SHPENDI KËRKONTE LIRINË**

Gati 100 vjet më parë u vra nga ushtria pushtuese e Malit të Zi, në pabesi atdhetari Mehmet Shpendi, Çun Nika, Marash Delia dhe dhjetra burra e gra, nga Pulti, Shala dhe më gjerë, në Plan të Pultit.

Në kuadrin e këtij përvjetori po botojmë një letër të atdhetarit Mehmet Shpendit, gjetur, përkthyer dhe pajisur me shënime nga studiuesi Pal Doçi, publikuar, për herë të parë, në shtypin e kohës, në vitin 1971. Prijësi i Djelmnisë së Shalës, Mehmet Shpendi, këtë letër i a dërgonte "Komitetit për Shqipërinë" me qendër në Romë, vetëm 6 ditë përpara se të fillonte kryengritja në Shqipërinë e Veriut. Kjo letër hell dritë mbi disa çështje të rëndësishme të kësaj kryengritje. Letra i ishte dërguar N. Ivanajt, i cili aso kohe ndodhej në Romë dhe përpiqej për të mbledhur ndihma për kryengritjen, për ti a dorëzuar atij komiteti. Ky Komitet nuk qe i angazhuar si duhet në këtë drejtim, megjithëse Mehmet Shpendi dhe ndjekësit e tij kishin shpallur hapur se ishin për luftë me armë në dorë kundër pushtuesve. Në këtë letër Mehmet Shpendi tregon për Luftën dhe thyerjen e ushtrisë turke në Qafën e Agrit në vitin 1910, shfaqë mendimin se dikush ka ndikuar në dorëzimin e armëve nga malësorët dukagjinas, pas futjes së forcave turke nga Shkodra, dhe tregon se ata që nuk i dorëzuar u detyruan që të largoheshin nga shtëpitë e tyre. Në këtë letër dalin qartë gënjeshttrat dhe pazaret të bënte Krajl i Cetinës, duke dashur që të merren arme të reja nga Rusia dhe tu jepeshin malësorëve armët e vjetra dhe jashtë përdorimit. Letra është shkruar dhe nisur nga Podgorica.

Mehmet Shpendi me trimat e tij vlerësonte në çdo kohë lirinë e krahinës dhe Shqipërisë, për të cilën nuk kursyen as jetën 100 vjet në parë.

"Të nderuarit "Komitet për Shqipërinë" Romë  
Podgoricë, 18.III.1911

Duke vijuar përpjekjet për çështjen tonë kombëtare, morëm vesh se në Romë gjendet komiteti Juaj i nderuar, i cili ka për



qëllim të ndihmojë atdheun tonë. I shtyrë nga dëshira atdhetare, marr guximin që me këtë letër t'ju vë në dijeni të ngjarjeve të ndodhura dhe të disa problemeve të tjera për të cilat shpresoj se do të jemi të një mendimi.

Ushtria turke desh të hynte në Shalë nga ana e malit të Nikajt dhe të mblidhte armët. Duke qenë i par i gjithë malit tim, ngrita malësorët në kryengritje. Me forcën e armëve e mbajtëm luftën dhe e detyruam ushtrinë turke të zbrapset.

Pasi i tërhoq ushtria turke, mblodha malësorët që luftuan nën prijën teme për ti nxitur që të mos i lëshonin armët, por nuk e di si ndodhi puna, ç'i shtyri ata të

ndërpresin luftimet dhe kështu dhanë armët përveç meje dhe 35 shtëpive të tjera.

Pasi ushtria turke hyri në Shalë nga ana e Shkodrës e mbajta edhe disa ditë luftën, por për shkak të borës së madhe, u detyrova të braktisë vendin e të shkoj në Podgoricë.

Posa u hap fjala se do të mblidhnin ushtarë, djemtë e shënuar u arratisën dhe presim ende lajme mbi këtë ngjarje.

Më kanë thirr disa herë në Cetinë. Ndër shumë të tjera pata edhe një takim me Kralin. Ai më tha se brenda pak ditësh do të keni armë sa të doni. Po të holla nuk jua jap dot, por çmimi do të jenë shumë i ultë. Ka disa ditë që presim, por deri

tash asgjë s'na kanë dhënë. Këto dy-tre ditë malësorët janë pështjelluar. Kërkojnë armë. Duam të shkojmë sa më parë të luftojmë për lirinë e atdheut, -thonë që të gjithë.

Pikërisht për këtë arsye, ditur as kushtet as pikëpamjet tuaja, sot po marr lejen që me këtë letër të pyes qartë dhe të marr një Ju njoftime mbi qëllimin e këtij komiteti, që të bashkuar të mund të arrijmë qëllimin.

Duke qenë prijës i krahinës, kam nën komandë rreth 10 mijë djem të aftë. Jemi në një shkallë të lartë gatishmërie për të luftuar për shpëtimin e Atdheut. Por, e keqja është se tash për tash jemi shumë të varfër, sepse kemi pësuar dëme të mëdha nga perandoria otomane.

I shtyrë nga dëshira për të gjetur ndihmë, i nxitur edhe nga kërkesat e pareshitura të malësorëve, me anën e kësaj letre kërkoj prerazi në se jeni në gjendje të na ndihmoni me armë. Në radhë të parë kemi nevojë për bomba dore. Po të na jepen armët e duhura, aftësinë tonë luftarake, jemi në gjendje të fillojmë kryengritjen, ta dëbojmë turkun nga mali ynë e pastaj, si të na jepet urdhri, ta përzëmë ushtrinë turke nga të gjitha malet tona. Me të marrë vesh se janë gjetur armët, mund të mblidhet një numër i madh njerëzish sa ai që përmenda më sipër dhe mund t'ja arrijmë qëllimit. Me këto forca do të jemi në gjendje t'i shkaktojmë ushtrisë turke dëme të mëdha, së pari në malet tona e pastaj kudo që të na jepet urdhri.

Këtu janë përhapur zëra se do të vinë armë, e janë mijëra vetë që presin armët. Lidhur me këtë ju lutem kini mirësinë të na njoftoni në se janë të vërteta këto fjalë, çfarë armësh janë dhe çfarë çmimi kanë.

Do të vija vetë atje e të bisedoja, por nuk kam mjete dhe detyrohem të ndalem me dëshirë që të marr përgjigje për sa shkrova.

Po ta shihni të nevojshme ardhjen time atje, ju lutem më shkruani se jam gati t'i përgjigjem thirrjes tuaj.

Në pritje të përgjigjes, mbetem me shpresë se do të plotësohen kërkesat e mija.

Me nderime Mehmet Shpendi"

Korrespondenti i "Dukagjini"-t

## NË ZELANDËN E RE PËRKUJTOHET DITA E MËSUESIT

Sipas publikimeve në internet shikojmë se me rastin e 7 marsit, Ditës së Mësuesit, shqiptaro-neozelandezët organizuan piknik të përbashkët në natyrë. Shumica e manifestuesve ishin ish-punëtorë të shkollës shqipe me dekada të tëra, duke filluar që nga viti 1948 Muhamet Fusha, 1953 Sali Sefaj, 1964 Burhan Gjerqeku, Besa Gjerqeku 1966, Sabit Abdylit 1968, Ilir Hoxha, Ali Hoxha, Luljeta Hoxha, Haxhire Jashari etj. Gjithë pasdrekën kokë më kokë kujtuan vitet e para të punës me ditar në dorë, u përmenden me admirim emrat e dshamirësit të arsimit shqip: Mehmet Gjevori, Beqir Kastrati, Tajar Hatipi, Rexhep Hoxha, Shefqet Veliu, etj. U diskutua gjetja e mënyrës për ruajtjen e gjuhës dhe identitetit të fëmijëve tanë. Ilir Hoxha lexoi një kumtesë të përgatitur në lidhje me rolin e mësuesit në shoqëri. Në mbydhjen u bënë edhe shumë fotografi.



# MARTIN CAMAJ, METEOR QË NUK SHUHET

Martini Camaj u lind në Telumë të Teralit në Dukagjini, më 13 korrik 1925 në vendin e quajtur. I biri i Kolë Camës, dhe Terezës. Nëna Terezë ishte nga Prekali, u lind i pari ndër shtatë fëmijë. Vendlindja e tij ishte, sipas vetë Martinit, "... në një vis të egër, 'ku s'ka shkelë kurrë kamba e kalit', kaq i thyeshëm ashtë ky vend". Martini, në vendlindje do të kalojë dhjetë vitet e para të jetës së tij. Nis të fitojë në mënyrë autodidakte njohuritë e para në shkrim e lexim shqip dhe matematikë. Kjo gjë do t'i binte në sy ish-pagëzuesit P. David Pepës OFM, duke e nxitur që të ndërmjetësojë pranë instancave eprore në Shkodër që të bënin të mundur për për arsimimin dhe përgatitjen, pse jo, për meshtari.

Në vitin 1935 vendoset përfundimisht në Shkodër dhe fillon të marrë arsim të rregullt pranë kolegjit jezuit "Xaverianum", ku do kalonte edhe sëmundjen e tuberkulozit. Rektor i kolegjit në atë kohë qe P. Giuseppe Valentini SJ, prej të cilit mësojmë se arsimin fillor 5 vjeçar e kishte përfunduar në 4 vjet. Pesë vitet në vijim ai ndoqi rregullisht gjimnazin, gjë që i dha të drejtën për të vijuar studimet në liceun klasik të kolegjit. I ati vdes pak vite pasi Martini i vogël u fut në Kolegjë. Studimet detyrohet t'i ndërprisë në vitin e tretë, më 1946 - mbas mbylljes së instituteve fetare të Shkodrës.

Filloi në Prekal punën si mësues i vetëm deri më 1948. Camaj merrte pjesë në rezistencën kundër partizanëve komunistë me çetën e kapiten Gjon Destanishtës dhe në gusht qe i detyruar për të jetuar në ilegalitet deri sa ia arriti që të arratisë për në Jugosllavi bashkë me At Daniel Gjeçajn OFM dhe një grup të përbërë prej 36 vetave. Kështu nuk pati më rast të kontaktojë me familjen, një vëlla i tij bëri 30 vjet burg. Kryen për tre muaj një kurs intensiv për mësuesinë në Pejë (1 korrik - 30 shtator 1949), mandej punon një vit (1949-'50) mësues në Tuz në shkollën "Mahmut Lëkij".

Viti 1950 e gjen Martinin në Beograd ku u regjistrua në universitetin e kryeqytetit jugosllav. Diplomohet pas pesë vitesh në korrik 1955 duke dhënë provime diplome në degën e filologjisë romane me fusha kryesore gjuhë dhe letërsi italiane. Pas mbylljes së studimeve në Beograd, Camaj përgatitet për formimin pasuniversitar në albanologji pranë fakultetit filozofik të Universitetit të Sarajevës, i udhëhequr nga albanologu prof. Henrik Bariç, - kryetar i Institutit Albanologjik në Sarajevë.

Në bashkëpunim me të dhe me mentorin e dytë prof. Rikard Kuzhmiç vendos të promovojë në filologji duke përzgjedhur si temë doktorate "Gjuha e Gjon Buzu-



si botim i revistes "Shëjzat" (që e redaktonte prej tre vitesh dhe do ta bënte deri më 1971) nën titullin: Il Mesale di Gjon Buzuku. Contributi linguistici allo studio della genesi. Gjatë periudhës së studimeve Camaj iu përkushtua veçanërisht kërkimeve shkencore në terren në fshatrat e ngulimeve arbëreshe. Qysh më 1959 Koliqi i mundësoi të punojë si lektor pranë Universitetit në Romë, gjë që zgjati deri nga fundi i 1960. Kërkimet akademike të Camajt u përqendruan në gjuhën shqipe dhe dialektet, në veçanti në gjuhën e arbëreshëve të Italisë jugore. Në Romë ndjek rrethet letrare të këtij qyteti, ku njihet edhe me autorët emigrantë nga vende të ndryshme lindore, rusë, rumunë dhe sidomos me poetë baltikë. Ishin të gjithë anëtarë të një klubi me qendër në Londër.

Në dhjetorin e vitit 1960 vendoset në Mynih të Gjermanisë me një bursë dhjetë mujore të akorduar prej fondacionit gjerman DAAD (Shërbimi Gjerman për Shkëmbimin Akademik) për të cilën hyn dorëzanë me rekomandimin e vet etnologu dhe folkloristi Alois Schmaus, që drejtonte atëkohë Seminarin e Sllavistikës pranë Universitetit Ludëig-Maximilian. Camaj përzgjedh si vend studimi Seminarin e Gjuhësisë me synimin që të përvetësojë metodat e studimit gjuhësor historiko-krahasues.

Për përfundimin me sukses të kësaj ndërmarrjeje Camaj mbështetet për disa vjet me radhë nga fondacioni i DFG-së (Shoqata e Kërkimit Shkencor Gjerman), i cili i akordon një bursë kërkimore për të mbrojtur gradën e habilitacionit. Këtë gradë e fiton më datën 21 janar 1965 me venia legendi në albanologji duke fituar në të njëjtën kohë edhe të drejtën me qenë Privatdozent, përvojë që e kishte ushtruar si lektor vullnetar për realizimin e programit universitar duke dhënë kurse hyrëse të gjuhës shqipe qysh prej semestrit të dimrit në vitin akademik 1961-62

Prej 1965 deri në 1971 qenë vitet vendimtare për konsolidimin e vatrës albanologjike duke e vështruar si fushë komplekse të kërkimit shkencor. Më 1969 martohet me Erikën, me të cilën nuk pati fëmijë. Më datën 16 korrik 1971 merr emërimin si profesor joordinar në albanologji, ndërsa më 14 shtator 1978 emërohet ordinar me marrëdhënie punësimi të përhershëm, më 30 shtator 1990 lirohet nga detyra për shkak të moshës. Jetoj në Lenggries, vend që i kujtonte trojet ku kishte lindë. Martin Camaj ndahet nga jeta më 12 mars të vitit 1992 në Mynih.

Martin Camaj është i njohur si albanolog i shquar i gjuhës dhe kulturës shqiptare. Është përfshirë thuasë në të gjitha antologjitë dhe veprat ku flitet për shkrimtarët shqiptarë. Kërkimet akademike të Camajt u përqendruan në gjuhën shqipe dhe dialektet, në veçanti të atyre në Italinë jugore. Veprimtaria e tij letrare në harkun 45 vjeçar ka disa shkallë zhvillimi. Ai e nisi me poezinë, zhanër mbas të cilit i mbeti besnik gjithë jetën, kurse gjatë viteve të fundit u përqendrua shumë tek proza. Vëllimi i tij i parë me varg klasik, "Nji fyell ndër male", Prishtinë 1953, dhe "Kënga e vërrinit", Prishtinë 1954, u frymëzuan nga banorët e zonave ku u lind, malësorët e veriut, mbas të cilëve qëndroj shumë i afërt shpirtërisht edhe mbas shumë e shumë viteve në mërgim dhe pamundësie për t'u kthyer. Këto u ndoqën nga "Djella", Romë 1958, një novelë me disa vargje mbi dashurinë e një mësuesi me një vajzë të re. Përmbledhja e poezive "Legjenda", Romë 1964 dhe "Lirika mes dy moteve", Munich 1967, kishte disa poezi nga "Kënga e vërrinit", që u ribotuan në "Poezi" 1953-1967, Munich 1981. Vargu i pjekur i Camajt reflekton ndikimin e lëvizjes të poetit italian Giuseppe Ungaretti. Karakteret metaforike dhe simbolike të gjuhës së tij rriten me kohën, siç ndodh edhe me rangun e temave poetike të tij. Një përzgjedhje e poezive të tij e përkthyer në Anglisht nga Leonard Fox në vëllimet "Selected Poetry", Neë York 1990 (Poezi të zgjedhura), dhe "Palimpsest", Munich & Neë York 1991.

Me nismën e shoqatës "Atdhetare Dukagjini" dhe me mbështetjen e vëllezërve tonë brenda dhe jashtë atdheut, po punohet që së shpejti një përmendore për këtë figurë të shquar të kulturës shqiptare do të zbkurojë qytetin e Shkodrës.

Korrespondenti i "Dukagjini"-t

## poezi nga MARTIN CAMAJ

### MBRAMJA ASHTË LARG

Mbramja ashtë larg  
e ti je atje mbi kodër të blerueme  
ku gurzit që bashin zhurmë  
i përpiu dheu.  
Ti je atje me të bijën e heshtjes  
e me shoqe tjera e mendon për mue.  
Unë jam në detin e tingujve  
e ndër gjujt e mij ndieva  
peshen e tramit tue u ndalua me turr.  
Mandej i lëshova vendin një të vjetri  
e mes tallazit të krahe thashë:

mbramja ashtë larg e ti andej lumit.  
Heshtja prek qiellin me dorë  
E ti atje mbi kodër të blerueme  
njej gjurmët e diellit ndër qiell.

### LULE

Sonte më lajmëruen se ka vdekë një njeri  
Prandej jam i trishtueshëm, Lule.  
Dashunia ashtë e vetmja shtyllë guri  
Kur andej gardhit fluturojnë  
Shëgjetat e akullit.  
Dy zemra bashkë janë ma rrufeprojsë

Se dy shpata tu për tu  
Me teha përjashta  
Ideja e sosjes, Lule,  
kur je ti pranë ik si shpend i egër  
andej kah vjen terri.

### DREKË MALSORE

Sot ashtë marrë një gjak.  
Dy plumba lëshuen përdhe një burrë.  
Sot ashtë marrë një gjak.  
Nën tunin e spatës  
Pëlset rrashta e kaut te prroni.

(Drekë të mëdha po bahen sot!)  
Sot ashtë marrë një gjak.  
Gjama e burrave tërbueshëm  
Përzihet me erën e mishit ndër zjarme.  
E gjethi i Vjeshtës bie i djegun mbi  
kapuçat e bardhë  
Ndë tryeza, jashtë  
Natë. Në vorrezat mbi kodër  
Tokë e re, hanë e re.  
Ujqit janë ulë prej malesh  
E pijnë gjak në përrue.



# NË 90-VJETORIN E VRASJES

## LUIGJ GURAKUQI "TRIM TRIBUNI I VEGJËLISË"

Luigj Gurakuqi u lind në Shkodër më 19 shkurt 1879. Mësimet e para i mori në Shkodër. Ndoqi Kolegjin Shën Mitër Korona, në Kalabri, më 1897, ku pati mësues De Radën. Më vonë studioi në Universitetin e Napolit për mjekësi dhe shkencë natyrore, të cilat nuk i përfundoi. Që student u shqua si poet dhe publicist, duke bashkëpunuar me disa revista e fletore të kohës. L. Gurakuqi qe një patriot i madh për lirinë dhe të

ardhmen e popullit dhe të vendit të vet. Ai u bë një nga figurat më të mëdha të rilindjes tonë kombëtare. Mbas Turqit e Rinj shpallën kushtetutën e tyre për gjoja një farë lirie, Luigj Gurakuqi, në vitin 1908 kthehet në Shkodër. Kjo kohë përkon me fillimin e veprimtarisë së tij politike, dhe bëhet një nga udhëheqësit kryesor të lëvizjes kombëtare. Me 10 nëntor 1908 merr pjesë si delegat i Shkodrës dhe Arbëreshëve në Kongresin e Manastirit, ku u zgjodh nënkryetar i Kongresit dhe anëtar i komisionit për hartimin e alfabetit të gjuhës shqipe. Pas Kongresit të Elbasanit, Gurakuqi emrohet drejtor i shkollës normale në Elbasan. Së bashku me A. Xhuvanin, Sotir Pecin, Simon Shuteriqin, Petër Dodbibën, etj dha mësim me shumë përkushtim. Burrë fjale, trim, i vendosur, fisnik dhe me virtyte të larta, punoi pa reshtur për ruajtjen e bashkimit të shqiptarëve dhe tërësisë tokësore të Shqipërisë duke ngritur vetdijen e popullit dhe duke zhvilluar ndenjë kombëtare.



Në vitin 1911, L. Gurakuqi merr pjesë me armë në dorë në kryengritjen e popullit të Kosovës. Në Shkup takohet me kryengritësit, shkon edhe në Gjakovë me ftesën e Bajram Currit. Me 5 nëntor 1912 merr pjesë në mbledhjen e shqiptarëve në Bukuresht, mbajtur nën kryesinë e Isamil Qemalit, në të cilën u vendos për masat që duhet të merren për shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë. Pak ditë më vonë vjen në Durrës së bashku me delegatët e shqiptarëve të Bukureshtit. Me 28 nëntor 1912 është në Kuvendin Kombëtar të Vlorës si përfaqësues i Shkodrës. Luigj Gurakuqi përpiloi dokumentin historik "Shqipëria të bëhet që sot më vete, e lirë dhe e pavarur nën një qeveri të përkohshme". Zgjidhet ministër i arsimit në Qeverinë e parë të I. Qemalit.

Me pushtimin e Shkodrës nga ushtria e Malit të Zi gjurmohen dhe kapen shumë patriot dhe luftëtar, në mes të të cilëve edhe Luigj Gurakuqi. Ky internohet në Mal të Zi, nga korriku i 1915 deri në janar të vitit 1916. Pastaj caktohet si drejtor i përgjithshëm i arsimit dhe bëri një punë të madhe për normalizimin e shqipes së shkruar të përbashkët. Me punën e tij dhe të mbështetësve të tij patriot bëri të mundur hapjen e 200 shkollave shqipe. Kjo ishte një punë shumë e madhe në shërbim të arsimit kombëtar. Gurakuqi themeloi Komisionin Letrare Shqipe.

Më 1921 zgjidhet deputet i Shkodrës. Në qershor të 1924, bashkëpunon ngusht me F. Nolin, në qeverinë e të cilit merr postin e ministrit të financave. Ishte kundërshtar i vendosur i A. Zogut dhe nuk u pajtua asnjëherë me të. Me shtypjen dhe shpërndarjen e kësaj qeverie nga forcat zoriste, edhe Luigj Gurakuqi, si shumë patriot të tjerë, morri rrugën e arratisë për të shpëtuar ndjekjes, burgosjes dhe vrasjes nga forcat zogiste që erdhën në pushtet. Por nuk qe e mundur që të shpëtonte kësaj ndjekjeje. Edhe pse në Bari të Italisë, 90 vjet më par, më 2 mars të vitit 1925 vritet nga njerëz të pagur. Me 1957 eshtrat e atdhetarit të palodhur Luigj Gurakuqi u vendosën në dheun mëmë, të cilin e deshi dhe bëri aq shumë sa ishte gjallë. Këto ditë ishte 90-vjetori i vrasjes së tij, një vit jubilar, por nuk pamë asnjë ceremoni të zhvillohen në Shkodër në kujtim të tij. Gjithsesi emri dhe vepra e Luigj Gurakuqit rron dhe do të rrojë në kujtesën e popullit dhe atdheut. Dukagjini ka parë te Luigj Gurakuqi njeriun që i do të mirën vendit, prandaj e ka mbështetur në punën dhe politikën e tij, sepse ishte në shërbim të atdheut. Në zgjedhjen e tij deputet, Dukagjini i ka dhënë një mbështetje shumë të fuqishme. Për veprimtarinë e tij atdhetare, është dekoruar me urdhra e medalje nga më të lartat. Ai ka marrë edhe titullin më të lartë të kohës "Hero i Popullit".

Miku i tij, Hasan Prishtina, mbi varrin e tij do të shprehej: "Flej i qetë Gurakuq, shpagen tände do ta marrim me përparimin e Shqipërisë."


Vepra e Luigj Gurakuqit është e pavdekshme në shekuj, sepse ka qenë në shërbim të përparimit të popullit dhe vendit të vet.

Korrespondenti i "Dukagjini"-t

## BAJRAM CURRI HEROI I DRAGOBISË

90 vjet më parë, më 29 mars 1925, në një ditë të ftohtë të atij marsi, në malet e Dragobisë së Tropojës, Bajram Curri rrethohet dhe pas përpjekjesh të egra, pas përgjigjes kundërshtuese, flakë për flakë, thirrjeve të ushtarëve zogistë për tu dorëzuar, vritet në shpellën e një majë mali. Ai ra për të mos vdekur kurrë, ashtu siç bien trimat në mbrojtje të lirisë dhe përparimit të atdheut ashtu siç u ka hije burrave të maleve shqiptare. "Vdekja e tij më hidhëron posi një zi personale. Humbja për Shqipërinë është e rëndë". Kështu shkruante Faik Konica kur mori vesh vrasjen e Bajram Currit.

Bajram Curri u lind më 13 maj 1862. Që në moshë të re farë, vetëm 16 vjeç, i u kushtua luftërave kryengritëse për liri që po bënte populli shqiptar. Nga puna dhe vendosmëria e tij shpejt fitoi respektin e popullit të krahinës së tij, që e shikonin si prijësin e tyre dhe i dëgjonin këshillat dhe porositë e tij. Luftoi me vendosmëri si pushtuesit shekullor otoman ashtu edhe qarqet shoviniste që kërkonin të mohonin të drejtat e popullit shqiptarë dhe të copëtonin trojet shqiptare. Në fundshekullin e XIX dhe fillimin e shekullit të XX në Shqipërinë Veriore plasën kryengritje të fuqishme, në krye të cilave u shqua edhe trimi Bajram Curri.



Qëndrimi i tij në Konferencën e Ferizajt në vitin 1908, lidhja e tij me klube patriotike shqiptare jashtë atdheut, lufta në Qafën e Morinës, shpartallimi i armiqve në Qafën e Prushit, çlirimi dhe hyrja triumfale në Shkup në 1912, etj, që përgatitën dhe bënë të mundur shpalljen e Pavarësisë, e bënë Bajram Currit një figurë të shquar të Rilindjes tonë kombëtare. Në betejën për çlirimin e Shkupit përkrah Bajram Currit është edhe Mehmet Shpendi me trimat e tij nga Dukagjini.

Pas shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë, Bajram Curri, mbajti lidhje të forta dhe të vazhdueshme me patriotët shqiptarë, sidomos me Luigj Gurakuqin, duke i u gjetur në momente të vështira që kolonitë qyteti i Shkodrës. "Plaku i maleve" ka qenë shpesh në qytetin e Shkodrës, për të cilin ruhet shumë respekt.

Dukagjini ka qenë një strehë shumë e rëndësishme për patriotin Bajram Curri. Ai ka lëvizur shpesh në Dukagjin, është ndeshur dhe përcjell disa herë nga Tropoja për në Shkodër e anasjelltas. Disa familje dukagjinase, veçanërisht shaljanë kanë pritur në shtëpitë e tyre dhe përcjell me shumë respekt, shpesh herë këtë patriot, si familja e Lul Gjokës, Bejto Ndocit, Avdi Kolës, e të tjera. Madje, gjatë fillimit të viteve njëzet, qeveria e kohës bënte shumë kujdes se ku dhe me çfarë merrej Bajram Curri. Për këtë ka shumë korrespondenca midis qeverisë qendrore dhe prefekturave apo komandave të xhandarmerisë lokale në zonat e veriut shqiptar.

Edhe pas hyrjes së Shqipërisë në radhën e kombeve të pavarura, B. Curri nuk e pushoi punën dhe përpjekjet e tij për të drejtat e popullit shqiptar, për mbrojtjen e tërësisë tokësore të Shqipërisë. Ushtria austro-hungareze, gjatë luftës së parë botërore, e internojnë këtë patriot në Vjenë. Bajram Curri ka merita të veçanta, shumë të vjera, në demaskimin e veprimtarisë së forcave të errëta, sidomos në vitet 1920-1924. Në këtë kohë Bajram Curri u bë një zë i fuqishëm i vegjëlisë.

Duke parë punën e Bajram Currit, respektin që gëzonte, element të ndryshëm i kundërviheshin, kërkonin që të shmangnin, e kishin në shënjestër e tyre. Nën ndikimin e këtyre forcave të errëta, pas fitores së Qeverisë së Nolit, u detyruan që ta nxirnin në pension. Populli i Shkodrës dhe më gjerë protestoi, por më kot.

Bajram Curri qe njeri i veprimit, njeri i fjalës dhe i pushkës, ashtu si Dedë Gjon Luli, Isa Boletini, Mehmet Shpendi etj.

"Heroi i Maleve" nuk emigroi pas përmbysjes me armë të Qeverisë së F. Nolit, por vendosi që të qëndronte në vendin e vet, krah për krah me bashkëluftëtarët e tij në pritje të mundësisë së rikthimit të një mundësie përparimtar për vendin, deri sa u gjend i rrethuar dhe u vra nga mercenarët e qeverisë së kohës në Shpellën e Dragobisë.

Emri dhe vepra e Bajram Currit jeton dhe do të jetojë, sepse ishte në shërbim të popullit dhe vendit të tij, në shërbim të Shqipërisë.

Korrespondenti i "Dukagjini"-t

# VATIKANI DHE SHQIPTARËT

ME DATEN 7 MARS 2015, NE MJEDISET E HOTEL INTERNACIONAL, SALLA "BALSHA" U ZHVILLUA CEREMONIA E PROMOVIMIT TË LIBRIT "VATIKANI DHE SHQIPTARËT", BOTIM I SENATIT DEMOKRISTIAN, NË PRANI TË DHJETRA INTELEKTUALEVE, STUDIUESVE, SHKRIMTARËVE, KLERIKËVE, AMBASADORËVE DHE POLITIKANËVE.

Hapja e kesaj ceremonie u be nga Presidenti i ketij Senati, shkrikmtari Lazer Stani. Në ketë ceremoni folen: Publicisti Frrok Çupi, poeti Agim Doçi dhe Ahmet Dursun.

Nga Shoqata "Atdhetare-Dukagjini", mori pjese Ndue Sanaj, Lazer Stani, Ndue Mici, Zef Gjelloshi, Tringa Rapi, Petrit Troja, Prek Kosturi, Fran Molla dhe Tome Shpendi.

## SELIA APOSTOLIKE, MIKE E VJETËR E SHQIPTARËVE

Fjala e mbjatur në hapjen e ceremonisë së promovimit të librit "Vatikanin dhe Shqiptarët"



Lazer Stani,  
Presidenti i Senatit Demokristian

Profesori i mirënjohur Sami Repishti, në tekstin "Shenjtëria Juaj: Miresëvini në trojet tona arbënore!", shkruar në prag të vizitës së Atit të Shenjtë në Tiranë, sjell një fakt shumë interesant:

Në fjalën pershendetse për shqiptarët gjate vizites së tyre në Vatikan, 28 prill 1968, peseqind vjetori i vdekjes se Skenderbeut, Papa Pali VI u shpreh keshtu: "Bijte fort te dashtun shqiptare!... në qofte se historia ju ka pa të shtypun e të shperndame, miresia e Zotit ka premtue që ju, me të gjithë perfaqesueset e 'gjakut tuej të shprishur' (Papa e tha shqip kete fraze!), me veprimtarine e gjalle që keni në shpirt, dhe me njohuni të fitueme, jeni ba ure miqesishe e bashkepunimi, dhe në kete menyre, jeni ba para-ardhesit e eku-menizmit modern". Dhe shtoi:

**"Selia Apostolike gezohet që ban pjese me miqte e vjeter të Atdheut tuej, mbasi e numeron veten njeni nga ata që e kurr nuk u dolën fjalet".**

Pikërisht këtë pohim të fundit të atit të shenjtë, sjellë dhe libri, "Vatikanin dhe Shqiptarët", i botuar nga Senati Demokristian. Ky libër, që është produkt i konferencës shkencore "Vatikanin dhe Shqiptarët", nëpërmjet kumtesave të referuara nga historianët, intelektualët dhe shkrimtarët, që u bënë pjesë e kesaj konferencë dhe autorë të ketij libri, dëshmon pikërisht këtë fakt: Vatikanin është miku dhe aleati i vjetër i shqiptarëve.

Është fakt i njohur se historia e Shqipërisë ngjan me një galeri pikturash të fallsifikuara, ku kopja origjinale është tjetërsuar aq shumë, sa edhe me imagjinatën me të fuqishme e ke të vështirë ta përfytyrosh. Dhe një ndër kapitujt më të manipuluar të kësaj historie është ai i marrëdhënieve të shqiptarëve me Vatikanin. Manipulimi më i madh i fakteve, dokumenteve dhe dëshmime historike të marrëdhënieve të shqiptarëve me Vatikanin është bërë nga historiografia komuniste për arsye të pastra ideologjike.

Regjimi diktatorial stalinist e konsideronte Vatikanin si qendrën e reaktionit botëror dhe vetë komuniteti katolik një kontingjent i vazhduar "armiçsh". Për të argumentuar këtë historianët e oborrit shkruan pseudohistorinë, duke e paraqitur Vatikanin si armik të shqiptarëve, si sabotues të përpjekjeve të tyre për liri dhe pavarësi, si bartës të regresit dhe të errësirës shekullore.

Një faktor i dytë, por jo pak i rëndësishëm, në fallsifikimin dhe manipulimin e këtyre marrëdhënieve, është otomanizmi, i pranishëm edhe sot e kësaj dite në variantin neo-otomanist me jo pak ndikim tek një numër historianësh dhe studiuesish. Të dy këta faktorë, të ndërthurur e në bashkëpunim me njëri-tjetrin kanë ndikur që edhe në këto vite të tranzicionit politik, kërkimet historike të mbetën të keqorientuara dhe e vërteta historike të mbetën e pjesërisht e zbardhur.

Aleanca e komunistëve me neo-otomanistët (të dy grupet bashkohen dhe bashkëpunojnë në anti-evropianizmin e tyre) vazhdon të ketë ndikim të ndjeshëm në historiografi, duke ricikluar parreshtur procesin manipulues të historisë. Ky manipulim qëndron pikësisht në mosnjohjen dhe mospranimin e rolit që ka luajtur komuniteti katolik në historinë e krijimit të nacionalitetit shqiptar dhe, së dyti, në anashkalimin e marrëdhënieve që ky komunitet dhe shqiptarët në tërësi kanë pasur me Selinë e Shenjtë përgjatë shekujve.

Askush, përveç historiografisë tonë të ideologjizuar, nuk e vë në dyshim faktin se katolikët shqiptarë, pavarësisht se janë të pakët në numër, siç shkruan shkrimtari i mirënjohur Ismail Kadare, përfaqësojnë fenë e parë të shqiptarëve. Ata, vazhdon Ismail Kadare, kanë një zbritje vertikale në historinë dhe kulturën shqiptare të pashembullt. Ata i kanë dhënë nacionalitetit shqiptar simbole dhe shenja themelore nga Gjergj Kastrioti te Nënë Tereza.

Ata janë ura më e vjetër dhe asnjëherë e shembur që lidh Shqipërinë me Evropën. Është kjo arsyeja, që antievropianistët

dhe gjithë dashakeqinjtë që tmerrohen nga një nacional dhe një Shqipëri evropiane, kanë vënë në shënjestër emblemat e nacionalitetit shqiptar si



Gjergj Kastrioti dhe Nënë Tereza, madje shkohet deri atje sa mohohet pushtimi Osman dhe fjala pushtim përpiqet të zevëndësohet me fjalën bashkëjetës dhe administrator.

Sidoqoftë, asnjë manipulim dhe asnjë term i kompromentuar nuk mund ta tjetërsojë faktin tragjik të pushtimit, terrorin dhe masakrat që u kryen mbi shqiptarët gjatë pushtimit osman, dhunën e vazhdueshme, ndalimin e shkrimit të gjuhës shqipe, strategjinë asgjësuese të ndjekur ndaj shqiptarëve nga mesjeta deri në fillimet e shekullit të njëzetë.

Fakti që shqiptarët mbijetuan në Ballkanin me histori tragjike, pas atij terrori asgjësues dhe pushtimit që zgjati jo me vite, por me shekuj, në vështrim të parë ngjan si një çudi e historisë, si një absurd që nuk mund të argumentohet nëpërmjet faktografisë historike. Megjithatë, sikurse shkruan Ernesto Sabato "në politikë rastësi nuk ka".

E vërteta është se kjo mbijetesë nuk ishte "një rast fatlum i historisë", se kjo mbijetesë u siguroi së pari nga rezistenca e vetë shqiptarëve, por edhe nga mbështetja e vazhdueshme e Vatikanit për këtë nacionalitet martirësh, që i kishte dhënë krishterimit dhe Evropës figura të shquara të historisë dhe identitetit të saj.

Kjo mbështetje ka qenë faktor vendimtar në mbijetesën tonë, në momentet më të vështira të historisë. Këtë e dëshmojnë të gjitha faktet e sjella në konferencë, fakte që historiografia komuniste i ka manipuluar dhe keqinterpretuar. Shqiptarët duke qenë një popull me krishtërim të hershëm apostolik, kishin lidhje të konsoliduara më Selinë e shenjtë, lidhje që u faktorizuan sidomos gjatë qëndresës anti-osmane të Gjergj Kastriotit në një nga momentet më të vështira të historisë së qytetimit evropian dhe të krishterimit. Gjergj Kastrioti gjeti tek Selia e Shenjtë aleatin dhe partnerin e tij më të besuar, përkrahjen e pakursyer dhe solidaritetin e përhershëm në përpjekjet e tij për të frenuar dhe kthyer mbrapsht ushtritë pushtuese më të fuqishme të kohës.

Kjo aleancë midis Vatikanit dhe shqiptarëve nuk u dobësua as në vitet e pushtimit osman, përkundrazi ka qenë

vendimtare në mbijetesën dhe rilindjen e nacionalitetit shqiptar. Shkrimi i gjuhës shqipe, shkollat e para shqipe dhe Kuvendi i Arbërit, që shënon fillimin e procesit të Rilindjes Nationale me protagonist klerin katolik shqiptar, është bërë me mbështetjen e vazhdueshme të Selisë së Shenjtë, Vatikanit.

Pikërisht për këtë, në Konferencën Shkencore "Vatikanin dhe Shqiptarët", ne bëmë një përpjekje për të sjellë në vëmendje të publikut kontributin e Vatikanit në mbijetesën e Shqiptarëve dhe kontributin e klerit dhe të komunitetit katolik në kulturën,

arsimin shqip dhe në Rilindjen Nationale që i sollën shqiptarët në momentin më të rëndësishëm të historisë së tyre, Shpalljen e Pavarësisë dhe krijimin e shtetit të pavarur shqiptar me 28 nëntor 1912.

Unë dua të falenderoj sot historianët, Gjon Keka, Dorian Koçi, Katriot Marku, Nikollë Loka, Azem Qazimi dhe Thanas Gjika për punën e tyre serioze shkencore në përgatitjen e kumtesave për konferencë dhe që janë përfshirë si autorë në këtë libër.

Gjithashtu falenderoj në mënyrë të veçantë, poetin Visari Zhiti për esenë "Nënë Tereza dhe Shqiptarët", një sprovë bindëse dhe dinjitoze e Shenjtërisë dhe madhësisë së Nënës Terezë, ndërgjegjes së njerëzimit siç e kanë quajtur studiuesit.

Falenderoj gjithashtu, studiuesin dhe kritikun Agron Gjekemarkaj për esenë "Kodet kulturore në veprën e At Zef Pëllumbit", kesaj embleme të vlerave tona shpirtërore e nacionale, qe sfiduan tmeririn, terrorin dhe ideologjinë e dikaturës, sistemin e e antivlerave që u përpoq të instalojë.

Ndërsa eseja tjetër, shkruar nga poeti Ndue Ukaj, "Selia e shenjtë, pararojë e nacionalitetit shqiptar", trajton përmblendhtazi, mardhëniert e Shqiptarëve me Vatikanin dhe analizon pozicionin pararojë të Vatikanit në mbrotjen e çështjes shqiptare në momentet më të vështirë të historisë së tyre.

Në këtë botim, përveç kumtesave të referuara në konferencë nga historianët studiuesit dhe shkrimtarët, janë përfshirë një studim i Akademikut Neritan Ceka "Shqiptarët dhe krishtërimi i hershëm" si dhe mesazhet e Atit të Shenjtë dhe Presidentit të Republikës, z. Bujar Nishani me rastin e vizitës së Papa Françeskut në Tiranë.

Duke e mbyllur, dua të shtoj se Libri "Vatikanin dhe Shqiptarët", në tërësinë e vet, është një dëshmi e lidhjeve të hershme midis Selisë së Shenjtë dhe shqiptarëve, por njëkohësisht edhe një dëshmi e indentitetit tonë të patjetërsueshëm shqiptar dhe perëndimor, e të vërtetave tona historike, shkencore dhe kulturore, që na rendisin denjësisht në familjen e popujve të qytetëruar evropianë.



# BESIM DHE GRUAJA!

**KUMTESË E MBAJTUR NË PROMOVIMIN E LIBRIT "VATIKANI E SHQIPETARET", E ORGANIZUAR NGA SENATI DEMOKRISTIAN TË SHQIPËRISË**

Çfarë është besimi? A është vlerë? A është një pengesë për ti shkuar pyetjeve deri në fund? Lind për tu mbrojtur prej frikës, apo na ndihmon për ta mundurçdo frikë? Besimi është veçse një dritë e imagjinuar në fundin e një tuneli të errët, a po është më racional se çdo sistem, ideologji apo doctrine e shpikur prej dorës së njeriut që sot e përqafojmë?!

Çdo qenie humane Brenda saj mbart besim. Që prej ditës së pare të lindjes, përkatesinë dhe përkujdesjen prinderore e përkthejmë si dashuri dhe me besim të

shime te besimi i një shoqërie, një kombi, një gjinie, një race.

Shpikim e rishpikim sisteme për ta legjitimuar supermacinë tone e për ti mposhtur ata. Jemi të bindur se vetëm nëse përdorim çdo mjet ndaj tyre, besimi ynë nuk do të cënohet, do të evidentohet, do të lartësohet.

A është e mundur të kapërcejmë mbi këto paragjykimet? Mendoj se e kemi të mundur. Jo të lehtë, por e kemi të mundur. E kemi të mundur nëse bindemi se Vatikani është institucioni më i vjetër

që mund të më bëni, madje mundohuni të më sfidoni me dijen tuaj!".

Cila ideologji fton sot kaq hapur për sfidë apo garë? Komunizmi, fashizmi, apo ajo që na pëlqen ta quajmë demokraci?! Asnjëra, asnjëherë!

Sot në këto caste në Irak dhe në Siri, besimi islam ka pësuar deformimin më kulmor të 1400 viteve të tij ...

Në librin e shenjtë islam, pra në Kuran, Shën Maria përmendet plot 27 herë si figura më e shenjtë e gruas nga fillimi e deri në fund të njerëzimit. Shën Maria, trajtohet si modeli politik, shoqëror e pse jo revolucionar për çdo grua, kudo që e kërkon emrin e saj të gdhendur në pllakat e arta ...

Ndërsa gruaja myslimane në shumë vende të botës është zhytur në terr dhe kjo veçse për shkak të fshehjes së qëllimshme të figures së Shën Marisë, prej atyre që me ligësinë e tyre të pashembullt pretendojnë se e përfaqësojnë në besimin islam.

Papa Francesku, ndryshe prej shumë vendeve dhe liderve botërore, po



**Kush është Ahmet Dursun?** Ahmet Dursun është me origjinë shqiptare, nga Kosova, me nënë nga fisi i mirënjohur Pllana, ndërsa baba nga Gjakova, i fisit të njohur Duraku. Familja e tij, në vitin 1890 është shpërngulur nga Kosova. Gjyshi i tij ka lindur në Turqi dhe pavarësisht nga kjo, familja e tij gjithnjë kane ruajtur gjuhen e asaj kohe, pra gegërishten, doket e zakonet dhe e ndajnë veten shumë krenar që janë me origjinë shqiptare. Ahmeti ka ardhur në Shqipëri, në vitin 1991, pas një shekulli, në moshën 20 vjeç dhe banon në Tiranë. Ka studiuar në Akademinë e Arteve të Bukura, për kanto, për një vit e gjysme. Pas kësaj periudhe është marrë me biznesin ushqimor. Në vitin 2001 nis aktivitetin në fushën e restoranteve, si mjeshër i kulinarive të hershme. Nga viti 2008 shkruan në gazeta të ndryshme për gjerat që i bëjnë më shumë përshtypje. Në të njëjtën kohë është marrë dhe me shkrime e botim libri. Në vitin 2001 boton romanin e pare, në gjuhen shqipe, me titull "Pena e gardianit", i cili bene fjale për burgjet aktuale shqiptare. Në vitin 2013 boton një libër tjetër me "ESSE", me analiza për nder të prof. Adriatik Kallulli, pasi ishte njeriu që e nxiti dhe e inkurajoi të shkruaj shqip.

Ne bashkëpunim me Ministrin e Kulturës, ka në projekt përgatitjen e një dokumentar televiziv, për ti sjell në jete, në kohe kulturën e historisë sonë Ilire, me të cilin bën përpjekje të ndihmoje sado pak për t'u larguar nga inferioriteti kulturor, që po shfaqet kudo në mes shqiptareve. Mendon se duke pasur një të shkuar te tillë, së pakut do të ndjehemi të barabartë me kulturat që përpiqen të na dominojnë... Ai, gjithashtu ka një faqe te A. T. SH-ja, në të cilën bën intervista për pjesëmarrjen e gruas në jetën aktive sociale, ekonomike dhe politike, për të bere sa të jetë e mundur, që gratë shqiptare të gjejnë vend aty ku prej shekujsh e meritojnë...

plotë përpiqemi të ndërtojmë jetën tone mbi këto themele të mrekullueshme...

Kemi besim se zotërojmë aftësi mendore dhe jemi aq të bindur për këtë. Jemi aq të bindur sa ia kemi mbushur me ndjen vetes se shpeshherë jemi të pakrahueshëm me të tjerë ...

Kemi besim te shpirti ynë. Madhështinë e tij as që e shtrojmë në diskutim, aftësia jonë e shikimit na duket shumë e shkurtër, ndërsa e mendojmë për shpirtin tone të pa fund ...

Këto tre forma besimi, i zotëron çdo njeri në brendësinë e tij.

Mirëpo, ndërsa jemi kaq të sigurt te besimi ynë, te besimi i tjetrit shpesh kemi dyshime. Dashurinë e tij e shohim të deformuar, mendjen e tij të cinguar, shpirtin e tij të kufizuar ... atëherë ç'është kjo?! Çfarë jemi duke bërë?!

Madje nuk ndalemi këtu, por shpesh këto dyshime ndaj një individi i shumëzohet. Kolektivizohemi dhe ngrejmë dy-

dhe i pandërprerë i historise sonë, është kujtesa më e vyer e njerëzimit, që qëndron solid dhe fal besimit solidarizohet me çdo qenie njerëzore duke i avlerësuar pa fundësisht besimin e ti j... Mundemi vetëm nëse marrim shembull atë.

&&&

Sundimet totalitare apo diktatoriale besimin e kanë trajtuar, madje deri në dimensione monstruoze, si një ndjesi abstrakte. Sllogani i tyre edhe sot vazhdon të jetë: "nuk dua të besoj, dua të di ...!"

Pikërisht Vatikani ia ka dale ti shembë një nga një këto strofkulla të së keqes duke e racionalizuar për çdo nivel të menduarit, se njohja e natyrës është sfida e njeriut dhe kjo bëhet vecse me dije, e jo me instikte kafshërore të indoktrinuar atë një rregjimi të së keqes.

Pikërisht atë që Zotina e kërkon me ngulm në çdo libër të shenjtë: "mësoni sa më shumë që të dini sa më shumë. Përpjekja juaj për dije është lutja më e bukur

na fton ti bashkangjitemi një prej përpjekjeve më të vështira. Pikërisht grave në këtë rajone jo vetëm, t'ia kthejmë besimin e rrëmbyer djallëzisht dhe me dashuri, me mend e me shpirt të qëndrojmë të bashkuar që asnjë grua mos të zgjohet e lemerisur prej ëndrrës sikur po i kryqëzohet fëmija ...

Nëse vërtet jemi të bindur te besimi ynë, atë duhet ta dëshmojmë sot në një mënyrë sa më të prekshme, duke besuar në një vlerë të përbashkët, që përbën më shumë se gjysmën e njerëzimit sot. Kjo vlerë është veçse besimi që duhet të kemi te çdo grua, kudo!

Besiminukështëthjeshtnjëndjesiabstrakte,ështëeracionale!Aqsaështëdashuria,mendja,shpirti. Besimi i vërtetë është edhe Shën Maria, besimi i vërtetë është çdo grua ...

**Përgatiti Ndue Sanaj**

## Poezi nga Martin Camaj

Li

GJARPRI E GRUEJA

Ajo mbramë harroi trupin e vet  
Zbuluet

E në mëngjes e gjeti pikturë të varun

Në murin e gjanë dhetë pashë:

E kqyri dhe e kqyri e u zhduk.

Petkat e saj teren buzë detit

Me këmishën e gjarpnit mbi gurë.

Shtëpia tha se vjen prap,ajo, po

Deri mbasdite.

Mbasdite vonë, gjarpni i rrejtun

Doli prej nëngurit

E iu zgërdhesh vetmisë ndërsy,

Veshi këmishën e vjetër e shkoi

Me fjetë

MOTIV ARBËRESH

Në driza janë gjarpji't e zez

E ti je e xhveshun nën diell.

Në driza janë gjarpji't e zez

E rrijnë buzë në buzë,

E rrijnë buzë më buzë,

E jeta e tyne ashtë e bardhë,

E bardhë e bardhë nën diell,

E jeta e bardhë e bardhë,

Nën diell e bardhë, e bardhë.

Mjaltëzat lagin me mjaltë

Gurzit e projeve të thata.

Retë e Oqeanit

Eci krahas me to

Nëpër ditën e gjatë.

Aty ku vete

Asht skaji i kohës së matun

Me rrahje zemre milionësh

Në kërkim të një emni.

Retë me rrajë thella në det

Rriten e bahen lisa:

Ndër grykat e tyne fantazma

Konkisdadorësh

Vjelin pemë.

FUQIA E KONËS

Ngjyra e verdhë e fletëve

Shkurtoi dritën në faqe të veta

E të katundit jugor mbi kodrinën

Bote së kuqe.

Para derës rrin Kona

Me barrën e randë në gji,

Dashunon rrezet e pemëve të vokta

Në kanistër

Para burrit kalamendë gjumi.

Tjerr Kona në furkë:

Ngrohtësia e pejve të leshtë shpërtheu

Prej gishtavet

E lëvizja e fëmijës në parzëm

E dridhi në kënaqje të paskaj

MOTIV I VJETËR NË KTHIM

Shtatë vasha u çuen peshë

Kur ngjyra e korbit fluturoi

Përmbi shtyllën e jetës:

Sqepi i dukej i verdhë, gati i bardhë

Mes pendlave të zeza.

Shtatë vasha u quen peshë

E u turrën vrap me funda

Në duer sa qethi mbas korbave

E vetëm me za i tretën si plafa të murmë

Nën karmat e vendit tim.

Po s'erdhët ju, vasha,

Kur të zbardhen pusat e ujit

Në lumë përpara agimit,

Ngurzohen edhe duert e foshnjeve

Në palare.

# FTONI MEAT merr çmimin, "Lider i përpunimit dhe tregtimit të mishit" në Metronë e Detroitit

Revista "CORP", revistë e Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit në shtetin e Michigan ka shpalle kompanitë fituese për tregues të qëndrueshem dhe më tendenca në rritje për vitin 2014 në industrinë e prodhimit e përpunimit ushqimor dhe në fushën e bujqësisë.

Pikrisht në këtë aktivitet të organizuar në Qendrën VisTaTech në Kolegjin Schoolcraft në Livonia, organizatorët kishin përzgjedhur 37 fitues dhe midis tyre Kompania "Ftoni Meat" u shpall "Lider i përpunimit dhe tregtimit të mishit" në Metronë e Detroit për vitin 2014, çmim i cili ju dorzua, Presidentes aktuale të kësaj kompani, Luçiana Ftoni, vajza e pronarit Ndue Ftoni

Në këtë mbledhje shumë të rëndësishme për Ministrinë e Ushqimit dhe Bujqësisë mbajti një kumtëse shkëncore me tregues financiar, bashkëthemeluesi dhe bashkpronari i kësaj Qendre, Paul Saginaë, po ashtu bashkëpronar dhe themelues partner i Zingerman-së në CORP.

Kjo revistë mori në shqyrtim ato kompani, të cilat së bashku kanë një aktivitet financiar në shtetin e Michiganit me 90 miliardë dollar. Gjithashtu, keto kompani ofrojnë punësim për Michiganin në mënyrë të drejtëpërdrejtë ose të terthortë për 900 000 mijë banorë.

Në këtë aktivitet, zyrtarët e lartë të statistikave të shtetit raportuan se Ekonomia Bujqësore e Michiganit është zgjeruar me një ritëm pesë herë më të shpejtë se ajo e ekonomisë së përgjithshme.

Gjithashtu nga një studim i kryer nga University Product Center Michigan State i raportuar në këte aktivite tregoi se indeksi i rritjes së kesaj industrie është 145 herë më i lartë se në vitin 2013.

CORP raporton se kjo industri është aktualisht krenaria e shtetit Michigan. Kjo krenari rrjedh edhe nga rritja e eksporteve, të cilat kapin vlerën e 1 750 000 000 dollarve amerikan me Kanadanë, Meksikën dhe Japoninë.

Shteti i Michiganit prodhon më shumë se 200 mallra duke e bërë industrinë e bujqësisë së këtij shteti të rënditët e dyta pas Kalifornisë në SHBA-se. Ky shtet rënditët i pari në rang vendi për prodhimin e boronices, fasules, begonias, qershise, zambakeve, petunias, kungullit.

Shteti i Michiganit është duke fituar një reputacion gjithnjë në rritje për prodhimin e vererave. Për vitin 2014 në këtë shtet kishte 107 fabrika të prodhimit të veres vëndase nga 19 të tilla që ishin në vitin 1998 dhe 6 perqind e kesaj vere prodhohet nga rrushi vëndas.

Michigan është duke u bërë dhe një vater e prodhimit të birres artizanale me 131 shoqeri artizane të prodhimit të saj. Michigani zë vëndin e 5-të në SHBA për vitin 2014 (nga 50 shtete) për birren artizanale me 1 miliard dollar amerikan në

ekonominë e shtetit.

Qyteti Grand Rapids ka fituar titullin "Nderi Kombetar" për birren artizanale në rang SHBA-je. Industria e Ushqimit dhe Bujqësisë në shtetin e Michiganit rënditët e dyta në rang shteti nga treguesit ekonomik financiar pas industrisë së rende të prodhimit të makinave

(Qyteti i Detroit Kryeqendra e prodhimit të atomobilave në botë).

Jo pa qellim rënditem keto tregues për të treguar rëndësinë e pjesmarrjes së një biznesi e aq më teper shqiptar në një eveniment të tille, krahas kompanive me reputacion të lartë shteror në këtë degë që për nga rëndësia rënditët e dyta në

rang shteror.

Pikerisht Kompania "Ftoni Meat" me Qënder në Easter Market, në zemer të Detroit ishte përzgjedhur për tu nominuar për çmimin fitues. Komisioni i vlersimit të ketyre kompanive për të fituar do të merrte në konsideratë shume tregues, ekonomik e financiar dhe tendencat progresive të kompanise, mardhenjet me publikun, punsimin dhe mardhëniet punëdhënes e punemarres, mbajtja e qëndrueshme e çmimeve, shkuarja në destinacion e produkteve që ndikojnë në ruajtjen e të treteve në tregti.

Qindra kompani që ishin zgjedhur nga shteti 11 milionesh i Michiganit, CORP vlersoj me Medaljen LIDER vetem 37 nga to e midis më të mirave të percaktuar nga Ministria e Industrise Ushqimore ishte dhe kompania e biznesmenit Ndue Ftoni.

Në cermoninë e marrjes se çmimit "Lider" mori pjesë Presidentja e Kompanise Luçiana Ftoni, e cila pasi falenderoi profesoriatin që ishte në përbërjen e juries, foli për auditorin disa nga pikat ku kompania është perpjekur të arrij relutate sa më të larta nder të tjera ajo tha : " Në kushtet kur inflacioni dhe botror janë në rritje, kompania ka pase politika të qëndrueshmerise dhe duke mbajtur çmime nën nivelin e tregut të metrose në këtë mënyrë ka rritur volumin dhe klientelen. Në kompaninë "Ftoni Meat"-tha Luçiana, tendenca jonë ka qënë qe mishi e produktet e tjera të jenë sa me shumë organike larg atyre të trysnisë së stimulanteve biokimik. Gjithashtu kompanive të konsumit "Ftoni Meat" u ka shkuar afer duke u kursyer kohen dhe u ka ruajtur çmimin e marketit duke u siguruar furnizim me kompanine e transportit që ka vete biznesmeni Ndue Ftoni.

Gjithashtu Luçiana Ftoni, lajmroi auditorin se brënda pesë viteve të ardhëshme do të hapin në qënder të Detroit edhe dy markete të tjera, me qellim për tu shkuar më afer konsumatorit". Në fund ajo falenderoi edhe një herë të pranishmit dhe jurinë për vlersimin e punes dhe arrijteve të kompanise "Ftoni Meat"

Ndersa biznesmëni Ndue Ftoni është i lumtur për këtë vlersim që i vjen nga një organizacion i tillë në rang shteror. Kam marrë me dhjetra çmime dhe vlersime për gjithë keto vjet që jam në biznes, por sot e ndjeje vetin shumë të vlersuar për perkushtimin, punen dhe arrijten që ka pasë kompania ime, bashkepunetoret e mije dhe vetë personalisht. Ky vlersim me rrite akoma me shume ndjenjen e pergjegjesise në pune dhe në sherbim ndaj konsumatorit duke ruajt dhe permirësuar më shumë në të ardhmen keto mardhenjë, thote Ndue Ftoni.

Përgatite nga

Rush DRAGU – Michigan



Luçiana Ftoni (në mes) me çmimin "Lider i përpunimit dhe tregtimit të mishit", në Michigan





# NË PORTRET I VONUAR, POR, JO I HARRUAR

Mbi dy dekada e gjysëm kanë kaluar nga dita kur ai u nda nga familja, nga shoqëria, nga jeta. Një portret i tij mund të ishte shkruar edhe më përpara,

por vonesa nuk ka të bëjë me harresën. Sepse Pjetër Kol Dreni mbahet mend e kujtohet nga të gjithë ata që e kanë njohur, sikur të ishte larguar dje. Mbahet mend si një ndër intelektualët e parë të Zonës së Dukagjinit. Por mbi të gjitha mbahet mend e kujtohet si një njeri i mirë, i përkushtuar për familjen, për shoqërinë, për komunitetin dhe vendlindjen e tij me emër të madh e histori të lashtë.

Gjashtëmbëdhjetë vjeç ishte në ditën e parë të Çlirimit të vendit. Ai i gëzohej kësaj dite të madhe më shumë se moshatarët dhe madje krenohej. Krenohej sepse kishte dhenë kontributin e tij në fitoren e lirisë. 15-16 vjeçari Pjetër Kol Dreni do të vraponte nga fshati në fshat, nga zona në zonë duke kryer detyrën e korierit partizan në çetën e zonës së Dukagjinit që komandohej nga i mirënjohuri Gjon Marashi. Vëllai më i madh i Pjetrit, Mëhilli, kishte dalë partizan qysh në ditët e para të Luftës Çlirimtare. Ishte dhe kjo, që e nxiti Pjetrin, ti ngjante vëllait të madh, ndonëse moshë nuk e lejonte të barazohej me të.

Shkathtësinë e korierit të luftës, pas çlirimit të vendit, Pjetri do ta vinte në shërbim të komunitetit ku jetonte. Falë disa viteve shkollë ku kishte shkëlqyer në mësim, nisi punën e shitësit. Por kjo vetëm për pak kohë. Në vitin 1952, pushteti vendor i kohës do ta dërgonte në Shkollën pedagogjike Elbasan për t'u kualifikuar si mësues. Se Zona kishte nevojë për njerëzit e dijes, veçanërisht për armatën e mësuesve, të cilët do të realizonin veprën



më të mëdhe të atyre viteve, zhdukjen e analfabetizmit, sëmundjes shekullore që kishin "mbjellur" pushtuesit dhe shërbëtorët vendas në shërbim të tyre. Pjetër Kol Dreni do të dallohej për rezultate të larta në përvetësimin e dijeve të mësuesisë dhe këto dije do t'i vinte në shërbim të bashkëfshatarëve të tij. Për disa vjet rresht shërbeu si mësues në fshatin e tij të lindjes, në Abat, në Lekaj e në Vuksanaj të Shalës, si dhe në zonën e Shoshit. Përveç mësimdhënies në këto shkolla dhe kurseve kundër analfabetizmit, ai do të drejtonte edhe punën metodike me mësuesit e zonës. Aftësitë dhe përkushtimi në punë, do ta çonin gjer në detyrën e inspektorit të arsimit pranë lokalitetit të Dukagjinit.

Viti 1954 do të ishte një nga vitet më të shënuara për Pjetër Kol Drenin. Ishte viti kur ai u pranua në radhët e Partisë së Punës së Shqipërisë, dokumentin e së cilës e mbajti me nder gjer në frymën e fundit të jetës.

Krijimi i familjes në vitin 1957 do t'ja zbulonte jetën. Së bashku me bashkëshorten e tij të nderuar, Mrikë Lulashin nga Shoshi, lindën, rritën, edukuan dhe i arsimeuan në mënyrë shembullore dy djem e një vajzë, Mëhillin, Arbenin dhe Luçen. Por jeta ka tek e saj të papritura. Tre vjet pas martesës sëmurët dhe shtrohet për disa ditë në senatoriumin e Tiranës, një sëmundje kjo që e detyroi Pjetrin të ngujohet në fshatin e tij Abat. Ngujohet nga lëvizjet e rrugëtimit e gjata, por jo nga punët e përditshme të familjes e të shoqërisë. Angazhohet si askush në detyrat e pushtetit vendor dhe në drejtimin e organizatës së partisë në fshat, duke dhënë kontribute konkrete në mbarëvajtjen e punëve. Dallohej veçanërisht në komunikimin me njerëzit e hallet e tyre. Dhe s'kishte si të ndodhte ndryshe. Komunikimin e ngrohtë e kishte jo vetëm nga profesioni i mësuesit, por edhe nga edukata që kishte marrë në familje. Shtoi këtyre dhe përkushtimin për njerëzit e për punën, çka do ta bënin personazhin e shkrimit tonë të respektuar e të nderuar nga të gjithë.

Pjetër Kol Dreni, ishte optimist për jetën. Ndonëse e dinte sëmundjen e tij të rëndë e të pashërueshme, ai nuk u dorëzua gjer në dekurajë e fundit në vitin 1989, vit që e ndau nga jeta, kur ajo ishte ende aktive. Shumë porosi i la bashkëshortes, Mrikës, por më kryesorja ishte ajo për fëmijët. Dhe Mrika ia kreu amanetin. Të tre fëmijët u rritën, u martuan dhe gëzojnë me fëmijët e tyre. Djali i madh, Mëhilli, do ta zëvendësonte të atin në detyrën

e mësuesit, duke e ushtruar këtë profesion të bukur në Abat, në Lekaj, në Gimaj e Ndrelyesë. Aktualisht Mëhilli gjendet në emigracion në Itali, por asnjëherë nuk është shkëputur nga hallet e familjes e të vendlindjes. Që nga Italia ka kërkuar të pranohet si pasardhës veterani, si pasardhës i babait të tij dhe të paiset me dokumentin kuq e zi me shqiponjën dykrenare, që simbolizon flamurin tonë kombëtar. Në të njëjtat "shina" udhëtojnë edhe Arbeni e Luçja, vëllai e motra e Mëhillit, që kanë krijuar çerdhet e tyre familjare. Dhe kjo e gëzon pa masë Mrikën. Gëzimi për fëmijët, për jetën e tyre të shëndoshë familjare ia lehtëson asaj dhimbjen që i ka lënë ndarja me Pjetrin, shokun e saj të jetës.

Mbi dy dekada e gjysëm që Pjetër Kol Dreni është ndarë nga familja, nga shoqëria, nga jeta. Një kohë jo e pakët për të përcjellë dhimbjen e për të mos humbur kujtimin. Por nuk mund të harrohet korieri 16 vjeçar i çetës partizane të Gjon Marashit. Nuk mund të harrohet mësuesi veteran i luftës kundër analfabetizmit dhe i përhapjes së dijeve tek brezi i ri. Nuk mund të harrohet intelektual i Abatit dhe gjithë zonës së Dukagjinit, që vuri gjithçka në shërbim të komunitetit ku jetonte. Nuk mund të harrohet miku e shoku i të gjithë atyre që e kanë njohur e punuar me të. Ashtu siç nuk mund të harrohet ai nga njerëzit e tij më të farët, nga bashkëshortja, fëmijët dhe nipat e mbesat e tij. Kjo ishte dhe shtysa që na bëri të shkruajmë këta rreshta modestë, të cilët do të përcjellin jo vetëm respektin tonë, por edhe kujtimin për njeriun që vitet e jetës ia kushtoi me përkushtim vendlindjes së

Martin Çetina  
Mirash Ndreaj

## MESHË NE KISHA KATOLIKE "ZOJA E SHKODRËS" NË 50-VJETORIN E VDEKJES SË NOLIT

(Nju-Jork)

*Kisha Katolike Shqiptare "Zoja e Shkodrës" në Harstdale – New York, ditën e Diel mbajti një meshë për të kujtuar 50 vjetorin e vdekjes së Tij, kurse Vatra me një veprimtari përkujtimore do të përkujtojë, gjithashtu – Imzot Nolin, ish kryetarin e Vatrës, editorin e parë të Diellit, themeluesin e Kishës Ortodokse Shqiptare në SHBA, diplomatin, përkthyesin, eruditin, Fan Stilian Noli.*

Ish kryetari i Vatrës zoti Agim Karagjozi – Presidenti i përjetëshëm i Vatrës duke vendosur një tufë me lule tek varri në varrezat qytetare "Forest Hills Cemetery" në rrugën Forest Hills Avenue, në qytetin bregdetar Boston të Massachusetts, aty ku ndodhet Varri i Nolit, (Seksionin 36 ne Redwood Avenue).

**BRONX NEW YORK :** Më 13 Mars bëhen 50 vjet që kur Kryepeshkopi Theofan Stilian Noli, vdiq në Florida – SHBA. Shqiptarët e Amerikës në përkujtim të 50 vjetorit të ditës, kur u nda nga jeta Noli, do të kujtojnë me nderim dhe respekt Imzot Nolin si një patriot të madh dhe klerik largpamës që bëri të mundur krijimin e Kishës Autoqefale Shqiptare, me bindjen se ne jemi të gjithë, pa dallim feje, motra dhe vëllezër Shqiptarë.

*Kisha Katolike Shqiptare "Zoja e Shkodrës" në Harstdale – New York, ditën e Diel mbajti një meshë për të kujtuar 50 vjetorin e vdekjes*

*së Tij, kurse Vatra me një veprimtari përkujtimore do të përkujtojë, gjithashtu – të premtën më 13 Mars, Imzot Nolin, ish kryetarin e Vatrës, editorin e parë të Diellit, themeluesin e Kishës Ortodokse Shqiptare në SHBA, diplomatin, përkthyesin, eruditin, Fan Stilian Noli.*

Shtypi shqiptarë në Nju Jork, shkruan se i Perndershmi At Pjetër Popaj – përkujtoi Peshkopin Fan Stilian Noli gjatë Meshës së Dielës, me rastin e 50 vjetorit të kalimit të Tij në jetën e pasosur, që bie më 13 mars. Prifti katolik shqiptar Dom Pjetri, i foli gjatë publikut mbi këtë figurë të madhe poliedrike të kombit shqiptar, duke theksuar trashigiminë e madhe që la në fusha të ndryshme, jo vetëm si bari shpirtëror ku la gjurmë me rëndësi historike, duke themeluar Kishën e Parë Ortodokse Shqiptare në Amerikë, dhe, duke u shërbyer besimtarëve shqiptarë në gjuhën shqipe, përketheu liturgjinë nga greqishtja dhe luajti rolin kryesor në themelimin e Autoqefalisë së Kishës Ortodokse Shqiptare.

Në këtë meshë në përkujtim të Tij, u tha se Ai la vepra të dorës së parë edhe si krijues i artit të letërsisë, poezisë, muzikës, historisë dhe gazetarisë, si përkthyes kryeveprash botërore dhe si intelektual i lartë me parime të demokracisë amerikane, parime të cilat u perpoq t'i sjelli edhe në jetën politike në atdhe. -

Gjithashtu, simbas organit të Vatrës, Dielli, thuhet se Federata PanShqiptare VATRA do t'a përkujtojë 50- Vjetorin e Vdekjes së Fan Nolit me një veprimtari përkujtimore pikërisht më datën 13 Mars kur pesëdhjet

vjetë më parë mbylli sytë në Florida – SHBA, prifti, përkthyesi, shtetari, diplomati, poeti e historiani shqiptar, kryetari i Vatrës, Fan Stilian Noli

Dielli shkruan se më 13 Mars 2015 mbushen 50 vjet nga vdekja e Imzot Nolit, ish kryetarit të Vatrës, editorit të parë të Diellit, themeluesit të Kishës Ortodokse Shqiptare në SHBA, diplomatit, përkthyesit, eruditit, Fan Stilian Noli. Veprimtaria, thuhet se do të organizohet në Shtëpinë e Vatrës, ditën e Premte me 13 Mars 2015 në orën 6 pasdite. Në këtë veprimtari, njoftohet se do të shfaqet edhe një dokumentar i përgatitur



nga televizioni TV Kultura Shqiptare dhe do të mbahen kumtesa nga historian, gazetar dhe studiues: zotërinjtë Prof. Dr. Muharrem Dezhgiu, Frank Shkreli, Idriz Lamaj, Anton Cefa, Sinan Kamberaj dhe Dalip Greca.

Ndërkohë, bëhet e ditur se me një mesazh përhëndetës vjen me këtë rast edhe nga Bostoni, dhe At Arthur Liolin, Kryekancelar i Kishës Ortodokse Shqiptare e Shën Gjergjit.

**Theofan Noli (Stilian Mavromati, 6 janar**

**1882 – 13 mars 1965, ShBA) prift, përkthyes, shtetar, diplomat, poet e historian shqiptar**

Ai u lind më 6 janar 1882 në Qytezë (turqisht: Ibriktepe), një fshat shqiptar në Trakë, jo shumë larg nga Edreneja. Si disa fshatra të tjerë të asaj krahine të banuar me shqiptarë, Qyteza kishte ruajtur me kohë gjuhën, doket dhe traditat e të parëve. Noli e konsideronte fisin e vet me prejardhje nga Qyteza e Kolonjës.

Më 1953, në moshën shtatëdhjetë e një vjeç, Fan Noli iu dhurua shuma prej 20 000 dollarësh nga Federata Vatra, me të cilën bleu një shtëpi, në Fort Lauderdale Florida, ku vdiq

më 13 mars 1965. Fan Noli është varrosur në Forrest Hill Cemetery, të Bostonit. Kisha Autoqefale që kishte krijuar u bë më vonë Kryedioqea ortodokse shqiptare në Amerikë e Kishës ortodokse në Amerikë.

Beqir Sina,  
marre nga Revista Online  
"Endërrat Shqiptare",  
data 12 mars 2015



## SHUMËSPORTESHI "VLLAZNIA", KLUB I SUKSESEVE DHE GJITHË PËRFSHIRJES

Shkodra ky qytet i lashte, me emër të madhe në histori, ka bere jehone e krijuar tradite edhe në sport, duke u bere kështu pjese e pandare e jetës dhe aktivitetit të Tij. Po fole për Shkodrën në mote dhe nuk the gjë për kulturën e sportin, në jetën e tij, zëre se nuk ke thënë gjë. Këto dy aktivitete të shoqërisë e komunitetit shkodran, i kane dhënë hijeshinë jetës në Shkodër.

Për zhvillimin e rezultatet e sportit në Shkodër, ka shume e shume për te folur e shkruar, por në këtë bashkëbisedim, menduam të ndalemi e diskutojmë, për mbarëvajtjen e rezultatet e punës, në Klubin shumë-sportesh "Vllaznia".

Nisur nga ky synim, menduam se rruga më e drejte dhe më e shkurte është të bisedojmë me Drejtorin e këtij Klubi, z. Mark Krroqi.

*Z. Mark! Në radhe të pare ju faleminderit, që krijuat mundësin, për këtë bisede informuese, me lexuesin e gazetës "Dukagjini", për gjendjen e ecurinë e ekipeve të ndryshme, të përfshira në klubin shumë-sportesh "Vllaznia". Besojmë që, nëpërmjet këtij komunikimi, publiku e në veçanti dashamirësit e lexuesit e kësaj gazete, do marrin një informacion më të plote e më të detajuar, për aktivitetin e objektivat e kësaj strukture të shumëllojshme e shumë-dimensionale sportive, të cilën Ju drejtoni. Mendojmë se lexuesi done të dije se kush është Mark Kroqi në karrierën tuaj sportive? Arritjet që keni pasur në ekipet lokale dhe atë Nacionale?*

Në radhe të pare dua të shpreh mirënjohjen e respektin tim, për Ju e botuesit e kësaj gazete, për mundësin që na krijoni, për të qene të pranishëm edhe mediatikisht, në mesin e këtij komuniteti të nderuar, i cili ashtu si në shume fusha të tjera të jetës e periudhave të lavdishme të historisë tone, ka pasur dhe ka kontribute të qensishme dhe nuk do e tepronim, të cilësonim se ka pasur edhe shkëlqim individësh, në historinë e zhvillimit të sportit, në Shkodër e në shkalle vendi.

Unë ndjehem i gëzuar dhe shume i lumtur, që po komunikoj nëpërmjet Jush, me lexuesit e gazetës së mirënjohur e domosdo edhe prestigjioze "Dukagjini", pasi kjo, tashme është një gazete, e cila ka krijuar emrin e vet shume pozitiv mediatik jo vetëm lokale, por dhe nacionale.

Për më tepër, si njeri, me një jete të tere aktive, në sport dhe me sportin, ndjej kënaqësi dhe me vjen shume mire, që në hapësirën tuaj mediatike, një vend të rëndësishëm zë edhe pasqyrimi i veprimtarive sportive.

Shkodra ka pasur, ka dhe do ketë sportist, sporte e klube të shumëllojshme, të cilat kane bere e do bëjnë emër të veçante e të lavdishëm, në jetën sportive lokale e nacionale.

Unë pata fatin të jem pjese e kësaj historie, shans të cilin ma krijoj kjo fryme dhe ky ambient, historikisht sportdashës e thellësisht sportive.

Dua të theksoj, me shume nostalgji e bindje, por dhe jo me pak krenari, se unë si shume bashkëkohës e bashkëmoshatarë sportist, jam fidan sporti i kultivuar në klasat sportive të shkollës tone, nga ku u ngjall pasioni dhe filloi me baza shume të shëndosha karriera jone e suksesshme sportive.

Unë kam ushtruar sportin e volejbollit, ku kam luajtur e qene pjesëtare shume aktiv i ekipeve e klubeve të ndryshme si "Vllaznia", "Dinamo", "Tirana (17Nentori)" e "Studenti", për gjate viteve 1975 deri 1993. Gjithashtu kam qene pjesëtar i ekipit Nacional të volejbollit, nga viti 1979 deri në vitin 1990.

Gjate karrierës time sportive në volejboll, ekipi i "Vllaznia", është shpallur tre here Kampion i Republikës, në periudhën 1980-1990.

Në ato vite, gazeta "Bashkimi", një nga dy gazetat më të mëdha dhe më prestigjioze në shkalle vendi, çdo fund viti, organizonte konkursin nacional të sportistëve më të mire të vitit, dhe unë jam rreshtuar, për disa vjet radhazi, nder 6 volejbollistët më të mire, 2 here kam fituar titullin "Sportisti më i mire" dhe një here kam fituar kupën F. SH. V (Federata Shqiptare e Volejbollit), si "Volejbollisti më i mire".

Në vitin 1986, më është dhënë titulli "Mjeshtër Sporti".

Dua të theksoj, për të më kuptuar drejt gjithë të rinjtë e të rejtat, që e duan sportin dhe kane dëshire ta ushtrojnë atë, për të qene dikush në sport, për të kënaqur sportdashësit dhe për të arritur rezultate të niveleve sa më të larta, sportistet e atyre viteve kemi qene, përgjithësisht të suksesshëm për të vetmen arsye dhe faktor, se ne ishim të përfshirë në ketë fushë me shume seriozitet, vullnet e këmbëngulje deri në kufijtë e pamundësisë. Në atë periudhe bënim dy here në dite stërvitje, me një kohëzgjatje prej 5 orësh.

Zoti Mark, me siguri që në karrigen tuaj sportive keni pas disa nga mbresat më të veçanta. A mundet të njihet me to lexuesi i gazetës "Dukagjini"?

Jeta sportive është e mbushur me kënaqësi të jashtëzakonshme, të cilat shpesh here janë të çastit dhe rastësore, prandaj edhe sporti është i bukur, por do veçoja nder to dy aktivitete:

-Ballkaniada e volejbollit e vitit 1981, e zhvilluar në Greqi dhe isha në përbërje të ekipit te vendit. Në këtë aktivitet Shqipëria zuri vendin e trete dhe unë u klasifikova nder 6 volejbollistët më të mire të këtij evenimenti.

-Një rast tjetër i veçante dhe kulmore në karrierën time sportive, janë finalët e Kupës së Republikës në Shkodër, në të cilin ekipi "Vllaznia" fitoi kupën dhe unë u shpalla volejbollisti më i mire i këtij aktiviteti.

Zoti Mark, jeni emëruar në detyrën e Drejtorit të Klubit Shumësportesh "Vllaznia"! Cilat janë disa nga arritjet kryesore të kësaj periudhe, të ekipeve sportive që mbulonin?

Jam emëruar në ketë detyrë në vitin 2012. Gjate kësaj periudhe, në saje të punës këmbëngulëse të gjithanshme të sportistëve dhe stafeve drejtuese, kemi arritur të kemi ekipe kampione në disa sporte në shkalle vendi si, në mundje Xhudo, në Boks, në Atletike, në Gjimnastike (femra) e në Basketboll (meshkuj).

Zoti Mark, në pune patjetër ka dhe problematika dhe që ju kane vu përpara përgjegjësisë për ti zgjidhur ato. A mundet të bëhen të njohura disa nga këto problematika të klubit në këto vite dhe sa keni arritur t'u jepni zgjidhje atyre?

Sigurisht që sporti është shume i rëndësishëm në jetën e çdo individi dhe atë shoqërore. Për mes tij, sidomos fëmijët, të rinjtë e të rejtat, por edhe të rriturit, arrijnë të kultivojnë e persosin me shume aftësi fizike e shëndetësore, morale e shoqërore, punën në grup, krijojnë lidhje miqësore, të cilat i shoqërojnë gjate gjithë jetës së tyre, prandaj jo kot qeveritë i japin rendësi dhe e mbështetin financiarisht sportin.

Shkodra ka disa veçori në raport me qytete të tjera të Shqipërisë. Në radhe të pare ka një popullsi historikisht shume sportdashëse dhe e dyta ka pasur dhe ka sportiste shume të talentuar.

Nisur nga këta faktorë diktues dhe shume të rëndësishëm, për kultivimin e zhvillimin e sportit, jam motivuar dhe kam bere të gjitha përpjekjet që S. K (Sport-klub) "Vllaznia", në këto vite, që unë drejtoj, të fus një fryme të re pikërisht duke u bazuar tek këto element

bazik të sportit.

Pasi kam evidentuar problemet e trashëguara, në infrastrukture dhe në përbërjen e elementeve në ekipe të ndryshme, kemi kërkuar fonde shtese, për të mbështetur sa më mire sportet e të ndryshme, sidomos në përmbushjen e standardeve të terreneve sportive, ku me problematiku ka qene "Pallati I Sportit" dhe shpërbimet financiare, që ato të bëhen mbi bazën e cilësive sportive, rezultateve dhe meritave ne sport.

Tani besojmë se jemi përgjithësisht në rrugë të mbare, pasi të dy këto kushte, shume të rëndësishme janë plotësuar në mase të kënaqshme. Dua të veçoj këtu se, pallati i sportit aktualisht, në Shkodër është me i plotësuar me kushte fizike të mjediseve, në shkalle Republike.

Problem parësore, në ketë faze mbetet palestra e mundjes, për t'u përmirësuar e bere me parametra ndernacionale, të cilën kemi synim për ta realizuar brenda këtij viti.

Gjithashtu, një prioritet, për të cilin po punojmë me shume përkushtim, është ri-ngritja e ekipit të çiklizmit, që besoj se do e fusim në rrugë të mbare, në fillimin e vitit të ardhshëm.

Sigurisht, për të krijuar baze të shëndoshë dhe siguruar vijimësi, kërkohet pune e vijueshme dhe e pandërprerë me ekipet e moshave, të cilat aktualisht stërviten në terrene e ambiente sportive, që nuk i plotësojnë standardet e kërkuara. Në ketë drejtim, me gjithë kushtet e vështira e mungesën e mundësive financiare, po bëjmë përpjekje për të gjetur rrugë e mundësi bashkëpunimi, sidomos me Drejtorin Arsimore e drejtorit e shkollave, për një shfrytëzim, sa më efikas dhe produktiv të ambienteve sportive, si nga nxënësit e shkollave dhe ekipet sportive.

Zoti Mark, në gjendjen aktuale, cila është gjendja e ekipeve të klubit, në sporte të ndryshme dhe synimet për klasifikim në shkalle vendi?

Gjithmonë ka vend për më shume pune dhe për më shume përsosje cilësore e aritje, por duhet thënë se përgjithësisht ka gjendje të mire dhe premtuese tek shumica e ekipeve, në sporte të ndryshme. Theksoj se, pretendojmë bindshëm, që edhe ketë vite të shpallemi kampion Republike në sportet: në Xhudo, në boks, në atletike, në gjimnastike (femra) e në basketboll (meshkuj).

Ju jeni një jete e tere dhe e pa ndare nga sporti, prandaj edhe bisedat me ju dominohen për sportin. Ju flisni me pasion e simpati për shume figura sportive të Shkodrës, të lavdisë së më përparshme, por edhe të elementeve të rrije sportive bashkëkohor, me shume perspektive.

*Si lidhen e bashkohen brezat sportive? Si krijojnë ato, trashëgimin pozitive sportive, për vijimësinë e rritjen e rezultateve të mëtejshme, për ta bere Shkodrën sportive edhe më të lavdishme në të ardhmen?*

Kjo pyetje, për çdo sportist karriere, i cili e ka pasur sportin pjesën më aktive e më të lavdishme të jetës së tij, është shume ngacmuese. Ajo të sjell e të shfaq në ekranin e kujtesës, me radhe sporte e rekorde brezash të ndryshëm sportive. Kjo behet edhe me veçante, për një ambient e hapësire njerëzore kaq prodhimtare sportive, siç është Shkodra e rrethinat e saj. Prandaj edhe e kam shume vështirë të përgjigjem e të pasqyroj me ketë rast gjithë atë mori emrash e sportistesh, të cilët i kane dhënë aq shume sportit, në nivel lokal e republike, duke e përfaqësuar Vendlin denjësisht edhe në aktivitete ndërnacionale. Lista e tyre është shume e gjate. Do duheshin jo flete, po libra të tere. Jo minuta e ore, po dite e net të tere, për të pasqyruar gjithë atë kontribut njerëzor, ne sporte të ndryshme, të ekipeve shkodrane.



Unë, me ketë rast duke kërkuar falje, për mos citimi te të gjithë atyre emrave kontribuues, po cilësoj vetëm disa nga ata, që janë jo vetëm pritshmëri, por edhe krenari e komunitetit që përfaqëson kjo gazete e nderuar.

Trashëgimia sportive e Shkodrës fillon që në vitin 1919, kur me qindra sportiste (duke filluar me Pjeter Gjoken, Mark Grimen, Palok Niken e të tjerë), të cilët kane dhënë tonin veprimtarive të ndryshme sportive në nivel vendi dhe jashtë tij, nder vite u janë shtuar edhe sportiste nga rrethinat e Malësitë e Shkodrës (kryesisht në sporte të ashtuquajtura të forcës), si Dede Bregu, Mirash Vuk-sani, Eliaz Guri, Nikoll Grima e të tjerë, të cilët me shume dinjitet dhe cilësi të larte sportive, kane përfaqësuar Shkodrën dhe Shqipërinë, në shume aktivitete sportive nacionale e ndërnacionale, duke na dhënë rezultate, tituj dhe medalje nderi.

Tani pas viteve 90, Ne kemi fatin e madhe, që emrave të nderuar të këtyre ikonave të trashëguara të sportit tone, t'ju shtohen edhe emrat e të rinjve e të rejave shume të talentuar e me shume të ardhme në sporte të ndryshme, të cilët jo vetëm kane bere të mundur ruajtjen e trashëgimisë, por edhe t'i çojnë më përpara rezultatet e tyre, duke lartësuar krenarin sportive të Shkodrës.

Meqenëse gazeta Juaj informon opinionin e gjere publik, dua të theksoj një element të veçante, apo risi të zhvillimeve sportive, të pas viteve 90-të, e cila qëndron në faktin e shume të pranueshëm, se përveç sporteve të ashtuquajtura të forcës, të cilat i theksova më lart, tashme shume element me prurje nga Malësitë Tona, jo vetëm që bëjnë pjese në ekipe të sporteve të ndryshme, por edhe kane role kyçe e përcaktuese, në arritjen e rezultateve të larta.

Shume prej tyre, jo vetëm që janë të formacioneve baze, por edhe anëtarë të ekipeve nacionale dhe përfaqësojnë Shqipërinë në aktivitete të ndryshme ndërnacionale.

Të tille mund të veçoj vëllezërit Qafarena në volejboll për meshkuj, Shqipe Molla, Ana Gjelij, Paula Koceku e Klodeta Zhivani në volejboll për femra e të tjerë, të rrije e të reja, në ekipe të ndryshme sportive.

Përmes gazetës së nderuar "Dukagjini", dua të falënderoj të gjithë prindërit e këtyre talenteve, për mbështetjen e përkrahjen, që u japin dhe do t'u jepja një mesazh dhe prindërve të tjerë, që të nxisin fëmijët e tyre, për t'u marre me sport, për të mirën e shëndetit e jetës së tyre, por edhe për lavdin e sportit shkodran e atij nacional.

I nderuar Mark, faleminderit për bashkëbisedimin që bëmë bashke dhe ju uroj me faqe të bardhe në detyrën tuaj dhe misionin që keni marre përsipër!

Ju faleminderit ju, zoti Dede, që më dhatë mundësinë për të komunikuar me lexuesit e gazetës së nderuar "Dukagjini" dhe mendoj se nuk do të jete e fundit.

Bashkëbisedoi Dede Zhivani



# JO, ZOTI PRESIDENT I SERBISË, DEKLARATA JU AJ KUNDËR SHQIPTARËVE NË STADIUMIN "PARTIZANI" TË BEOGRADIT ISHTE E PAFALSHME PËR NJË POLITIKAN NORMAL



Pergatite nga Dr. **Nike Bunjaj**, shkrimtar, publicist

Ne shqiptaret s'kemi qene kurre te pa bese, s'jemi treguar asnjehere dashakeq sidomos me shtet fqinje. Nuk I kemi rene kujt ne qafe, por s'kemi pranuar qe as te tjeret t'na bien ne qafe. E dini mire historine se kush na ka ra ne qafe dhe ka tentuar ten a cenoje e ten a plaçkise. Kane ndryshuar koherat, por ju s'po dini te ndryshoni kurre, brez pas brezi. Ndaj ska se si shpjegohet ndryshe qendrimi juaj si President I Serbise e te ngriheni ne kembe ne tribune VIP te stadiumit ne Beograd, ne te cilin po luhej futboll mes dy nacionaliteteve respektive te Shqiperise dhe te Serbise.

Ju, si President u nxit u nxit tifozat per kore raciste: "Rrahni dhe vrisni shqiptarert ...". Kjo ishte thirrje e juaj, jo vetem e turpshme, por edhe nxitese e asaj çka ndodhi me pas, nxitese e nje skandali te papare. Shprehja e juaj e gabuar eshte kritikuar rende jo vetem ne Evrope, por edhe me gjere. Futbollistet tane u rrahen nga policia juaj duke zbatuar

urdherin tuaj "rrihi dhe vrisni shqiptaret" ...

Ju zt. President keni qene dhe per çudi jeni faqja e zeze e nacionalitetit tuaj. Nacionalja shqiptare erdhi per te luajtur futboll, ndersa ju flisni si ne kope uqerish, qe vetem uqer s'jane per t'i rrahur. Turp te keni zt. President!

Ne shqiptareve na vjen keq te flasim ne kohet e sotme per sulme te pergjakshme, grabitje dhe fyerje, por ju qe kerkoni te hapni plage te renda ndaj nesh, edhe njehere ua kujtojme te mateni me fjalet tuaja te pakontrolluara. Shkrimtari i njohur, njekohesisht koloegu im, z. Driteri Agolli duke shprehur shqetesimin dhe keqardhjen per incidentin dhe dhunen e ushtruar ne stadiumin "Partizani" te Beogradit ndaj nacionales shqiptare, thekson: "Nje ndeshje futbollit u kthye nga serbet ne nje arene gladiatoresh duke ringjallur oreksin e vjeter shovenist".

Dha ja, per çudi pas ngjarjeve te renda qe ndodhen, u krijua edhe incidente te tjera, qe ishin djegia e flamurit nacional shqiptar dhe flamurit te NATO-s. dhe per te mos mjaftuar, ne krahu tjetër presidenca greke duke dhene deklarata qe nxisin mendimet e kaluara duke thene se "Himara eshte vorio-epirioe...". Tani ngrihet pyetja se kujt valle po ja drejtojne kete deklarate qesherake, e cila eshte hedhur poshte disa here me fakte historike.

Eshte per tu çuditur fakti se mbas nderprejes se ndeshjes se futbollit instancat e qeverise Serbe reagan nje zeri se per ato qe ndodhen nuk ishte faji i tyre. Reagimet e keture zoternjve nuk kishte ne perberje "keqardhjen" per incidentin e ndodhur qe ne fakt e kishin vet fajin per gjithçka, por reagan negativisht, si e kane pasur dhe do ta kene gjithmone ne gjak urrejtjen ndaj shqiptareve. Gjithashtu u shqua edhe Presidenti i Serbise, Tomislav Mikolij, i cili veç fjalimeve te tjera nxitese, tha: "Shqiperise do i duhen dekada, ndoshta shekuj qe te behet vend normal pa urrejtje ndaj serbeve ...". Kush ka studiuar sadopak historione e Serbise e Malit te Zi nga njera ane deh ate te popullit Shqiptar nga ana tjetër tregon teresisht te kun derten e Presidentit Serb ne stadiumin "Partizani" te Beogradit.

Miss Edith Durham qe jetpi rreth 30 vjet ne Shqiperi, ne vitin 1903, qe i shkeli per here te pare kema ne token shqiptare, I ka pare me sy disa nga sulmet e serbeve, ssidomos ne Malesine e Madhe dhe pergjithesisht ne Veri te Shqiperise, te cilet kane kryer krime macabre, si ne Kosove qe kane masakruar gra, femije dhe te moshuar. Prandaj z. President i Serbise, per veç histories tjetër, te lexoni mire librat e Miss Edith Durham, e cila pershkruan

tmerrin qe kane bere serbet ndaj shqiptareve ku ka qene deshmite e ketyre ngjarjeve makabre.

Vizita e Kryeministrit te Republikes se Shqiperise ne Beograd, me ftese te Kryeministrit te Serbise tregoi nje fare perpjekje per t'i lene pas hasmeerite e vjetra, por nuk u prit fare nga Presienti Nikolij, I cili nuk pranoi te takohej me z. Rama, por iku dhe u fsheh si minjte. Por as Kryeministri Serb nuk e priti mire thirrjen e Kryeministrit Shqiptar per te njohur Pavaresine e Kosoves, pasi e kane njohur mbi 100 shtete te tjera. Pasardhesi I kriminelit dhe kasapit te Ballkanit, Sllobodan Millosheviç, z. Nikolij, nuk pranoi te bej asnje hap drejt sigurimit te marredhenieve te mira mes dy shteteve. Ai, krahas deklaratave te tij, qe kemi theksuar me siper ne kete shkrim, nga fusha e "betejes" u shpreh me ze te larte: "Kosoven nuk e njohim dhe s'do ta njohim si shtet te pavarur. Kosova eshte Serbi".

Eshte per te ardhur keq per qendrimet e ketij presidenti, Presidentit te Serbise ndaj Shqiperise dhe Kosoves. Kjo tregon se ai, eshte dashakeq ndaj fqinjeve te saj, te Serbise se, duke qarte se çfare treguan ngjarjet e fundit per te cilat deshirojme sinqerisht qe te mos perseriten me.

## Çfarë duhet të dimë për infarktin e zemrës nën dritën e zbulimeve më të reja

Infarkti i zemres (Infarcti i myocardit) – IM është i lidhur me bllokimin nga një pirq (koagul) gjaku i arteres që ushqen zemrën (arteret coronare) dhe krijon një dëmtim në indin e zemrës (nekroza izhemike e myocardit).

Trajtimi konsiston ne hapjen sa me të shpejtë që të jetë e mundur të arteres së prekur deri në rivendosjen e qarkullimit të rregullt dhe të kufizohet shtrirja e prekjës së zemrës.

Objektivi i kërkimeve mjeksore është që të shpëtohet i prekuri nga infarkti (pra të mbijetohej), të evitohen recidivat (përsëritjet) dhe të ulen rreziqet tek personat e ekspozuar dhe të gjinden trajtime më të reja gjithnjë e më efektive.

### Infarkti i zemrës me shifra:

Rreth 120.000 raste të reja raportohen ne Francë çdo vit. Ndërkohë që vdekshmëria (mortaliteti) brenda 30 ditëve të para të sëmundjes ka rënë në mënyrë spektakolare që këtu e 15 vjet (nga afro 70% që ishte në 10% të rasteve), pacjentët vdesin në orët e afërta pas kalimit të infarkt, pa arritur akoma në spital (sidomos rastet e neglizhuara e te vonuara) dhe 15% vdesin gjatë vitit të parë. Popullsia që përmban patologji në evoluimin, popullsia nën 60 vjeç po shton numrat e infarkteve. Duhet shënuar se edhe gratë e reja janë më të prekura: në 2010, 25% e nën 60 vjeçarëve kishin kaluar tashme infarct, në kohën që në 1995 – Kjo moshë përmbante vetëm 10%. Infarcti i myocardit po behet me vdekjeprurës se sa kanceri i gjirit.

### Cilat janë shkaqet?

Pirja e duhanit kryesisht tek gratë  
Atheroskleroza shkak kryesor i infarktit te zemrës

Infarkti është vdekja e një pjese te muskulit te zemrës (miokardit).

Kjo prodhohet kur një arterie koronare, qe ushqen zemrën me gjak bllokohet.

Zona korresponduese e zemrës ne mënyrë te menjëhershme privohet nga ardhja e gjakut dhe prurja e oksigjenit duke vuajtur dhe dëmtuar ne mënyrë te pandreqshme.

Shkaku kryesor i infarkt është atheroskleroza që fillon me formimin e pllakës së atheromes e ndërtaur nga kolesteroli, fibrina dhe mbetje qelizore, mbi paretin brendshëm të arteries. Këto pllaka krijojnë një inflamacion kronik në nivelin e murit te arteries e cila si artere bëhet e thyeshme (fragjile). Pllaka mund të çahet (rukturohet) provokon krijimin e një trombi (pirq gjaku) qoftë në vend ose në distancë (pa të shkëputet) duke bllokuar arterien.

Ja dhe disa nga faktorët e rrezikut.

Duhan-pirja, niveli lartë i kolesterolit total dhe LDL – kolesterolit (Kolesteroli i keq). Tensioni i lartë (HTA), pirja e tepërt (keq përdorim) e alkoolit, mbipesha, mënyra e jetës pa lëvizje (sedentarizmi).

### Cilat janë simptomat?

Është kryesore që të kapim sa më herët shenjat paralajmëruese të një personi mbartës.

Dhimbja prapa dërrasës së kraharorit (retrosterenale) ne rajonin e zemrës, në qafë, në nofull, në shpine etj. që përhapet drejt krahut, prapa në shpatull e në raste atipike drejt stomakut, dhimbje e cila është e fortë dhe nuk qetësohet me analgjëzikët e zakonshëm.

Nganjëherë kjo dhimbje shoqërohet dhe

me shenja te tjera si ankth, frikë nga vdekja (një katastrofë e vërtetë), zënie frymë, tendencë për vjellje, zbehje, djersë të ftohta. Shenjat e infarkt ndryshojnë shumë nga një pacient tek tjetri dhe mund të mos ketë dhimbje sidomos tek diabetikët, të moshuarit dhe gratë (që gjithmonë e neglizhojnë).

### Cili është trajtimi!

Menjëherë sapo të dyshohet për infarct duhet të jepet **Trinitrine** nën gjuhë (0,3 – 0,5 mg) ¼ aspirinë (acid acedo salicilik) nga goja etj. Të njoftohet urgjenca për ta drejtuar në urgjencën e specializuar të njësive koronare. Objektivi i mjekëve është që të zhbllokohet (të hapet) arteria e taposur (bllokuar) dhe të rivendoset sa më shpejt qarkullimi për ushqyerjen e sektorit të zemrës. Në se kjo bëhet brenda 120 minutave të para nga fillimi i dhimbjes është me dobi, por prognoza (ardhmëria) varet dhe nga shtrirja e zonës së prekur. Në 70% të rasteve një angioplastikë (hapjen dhe vendosje stenti) është e realizueshme ku një kateter me një mikrobalon që fryhet ndihmon në hapjen e enës dhe vendosjen eventuale të një unaze rrethore për ta mbajtur të hapur vazen (enën e gjakut). Po ashtu përdoren dhe ilaçe që mbrojnë nga formimi i mpiksjes së gjakut (trombit) ose ndikojnë në shkrirjen e tij si **Klopidogrel (plavix) 75mg** në ditë ose **Aspirinë** 100mg në ditë si dhe statina për uljen e kolesterolit krahas masave të tjera higjieno-djetetike për një profilaksi sekondare kundër recidivës (rikthimit). Kërkime shumë intensive në luftë kundër infarkt it po përqendrohen për të përmirësuar depistimin (zbulimin) dhe marrjen nën kujdes për të kufizuar rrjedhojat. Pra duhet të paran-

dalohej kriza. Sot njihet roli i inflamacionit në zhvillimin dhe çarjen e pllakës së atheromes, pra kërkohet që me anë të ekzaminimeve të përcaktohet atheroma; po kërkohen biomarkerët e inflamacionit dhe po përmirësohet teknika e imazherisë mjekësore. Po ashtu po bëhen kërkime për rrugë të reja kuruese kundër inflamacionit lokal në pllakën e atheromës duke gjetur statina me efektive për të ulur kolesterolin si dhe antiagregant që të pengojnë formimin e saj. Gjenetika po ashtu po hap një pistë të re premtuese për të ulur rrezikun e disa pacientëve. Mutacioni i genit PCSK-9 lejon që ne personat mbartës të tij të ulët në nivel minimal kolesterolit dhe të mos vuajnë nga atheroskleroza as nga infarkti. Shkencëtarët po kontrollojnë funksionin e këtij gjeni tek pacientët me rrezik të lartë për sëmundje cardio-vasculare.

Ka avancime shumë intensive me efekt të madh në marrjen nën kujdes të kësaj patologjie ku së fundi kërkimet kanë zbuluar se **Ciklosporina** po pengon hedhjen e transplantit (në trapiantet e zemrës) ose ajo ka aftësi të bllokojë disa mekanizma të vdekjes qelizore në kohën e infarkt. Ajo do mund të kufizojë kësajsoj prekjën e muskulit të zemrës. Kjo provë klinike nga fondi i kërkimeve mjekësore (FKM) është në vijim për të vendosur impaktin mbi prognozën dhe cilësinë e jetës së këtyre të sëmurëve. Rezultatet pritet të merren së afërmi. Së fundi po ashtu mjekësia regjenerative po vlerëson qelizat **Staminalë (burimore)** për të ndërhyrë në riparimin e indit kardiak të prekur në mënyra **in vivo**.

Përgatitë nga mjeku Ndue Nika

## Faqja Letrare \*\*\* Faqja Letrare \*\*\* Faqja Letrare \*\*\* Faqja Letrare

**NË BALL TË TRIMAVE MEHMET SHPENDI**

Malet dhe kodrat gjithandej ushtojnë  
Fushat, lumenjtë, pyjet gjëmojnë  
Në zjarr e flakë u përfshi vendi  
Në ball të trimave Mehmet Shpendi.

“Kushtrim burra sa ma parë  
S’kalon kënde asnjë barbar”  
Qafa e Agrit afër Qiellit  
E mbrojnë bijtë e Dukagjinit.

Si shkëmbinj ata qëndrojnë  
Grykë për grykë hasmin luftojnë  
Pushkët e tyre u kthyen në topa  
Shumë asqerë i përpiu toka.

Kurrë s’e trembi Krajli as Mbreti  
Legjendarin e krenarisë kombëtare  
Në bibliotekën “Marin Barleti”  
Nga Presidenti mori dekoratën.

**PËR LIRI MIRASHI KA VDEKË**

Në këtë ditë me shi të marsit  
Shumë burra u mblodhen bashkë  
Për të kujtue heroizmin e djalit  
Stërnip i një fisit të lashtë.

Nuk e mposhti tirania trimin  
Asnjë forcë dhe dhunë mizore  
E rriti Lokja e Dukagjinit  
Në mes shqipeve arbërore.

Kishte ardhë në këtë jetë  
Për të ba vepra të mëdha  
Për liri Mirashi ka vdekë  
Në ball të luftës jetën dha.

Para skuadres së pushkatimit  
Si drague Mirash Pal Vuksani:  
“Poshtë Fashizmi! Rroftë Liria!  
Për jetë do të rrojë Shqipëria!”

Me vendim të Komisionit Qendror  
Një martir në “Panteonin Arbëror”  
Dekorata “Dëshmor i Atdheut”  
Pishtar i pashuar i mëmëdheut.  
*nga Luigj Temali*

**GJAKMARRËSVE**

Gjakmarrje, hakmarrje... marrje...  
Mos bre burrë,  
Se Zoti s’ka me ta falë kurrë!

Mos del kundër Zotit!  
Mos kundërshtu urdhnat e tij!  
Se në jetën tënde,  
S’ke me pasë mbarësi!

Jeta e njeriut, vepër e Hyut!  
Jeta e njeriut, dhuratë e Zotit!  
Asht’ dëshira e tij,  
Ndaj s’mund ta marrësh kot së kotit!

Këta fjalë të thanuna prej tij  
Ndigjojeni o njerëz...  
Se ato sjellin paqe e mirësi!

Zoti jetën na e ka falë,  
Që ta gëzojmë të tanë;  
Askush s’ka të drejtë të na e marrë  
Veç ai që na e ka dhanë!

Ja ç’ka u thotë Fishta  
Këtyre njerëzve:  
“Ndaloni burra, ku veni?!  
Pashë Zotin, lëshoni hutat,  
Pse tepër gjak është derdhur.  
E tepër mbajtë kemi futat

Prej vajit na asht’ marrun zani  
Medet, o Qiell, medet!!!”  
*nga Ndue Mici*

**NË DUKAGJIN**

Nën hijen e maleve n’Dukagjin  
u rreshtuen korrilat n’radhë nepër qiell  
tuj ikë për n’jug.  
Poshtë lanë arat krejt djerr  
e një shegë t’ egër lakuriq n’degë  
me kokrra t’ngjeshuna rrast nën lvozhgë.  
Një plak që kishte nam qytetin qysh n’rini  
prek me dorë kokrrën e vetmume  
dhe e lëmon si fëmij  
mandej flet me vedi do fjalë si gjamë  
për racat e pamposhtme me rranjë mbi gur.  
Atje n’kodër nalt  
burrat grusht vendosnin kode, luftë e paqë  
në mal e verri.  
Atje n’kodër dikur mendimi ishte kangë,  
ishte tokë e diell,  
te ajo kodër nalt.....e plaku u mbush n’vaj.  
Brijat përball presin fierin e trumzen e re  
me dalë prej dheut n’pranverë  
e arat nën kambë bujkun e plugun e ri qetë me ngà.  
“Moj ara eme - thotë Camaj n’poezi  
- im at t’ka pasë  
e unë çka t’baj me ty?  
ara eme shtri mbi rrasë”.

**M’SOLLEN NJI LULE**

M’sollen një lule  
me brumin e tokës teme  
brenda kercellit deri n’gjeth.  
Nji vazo me dhë  
shkel qiejt e globit  
e m’gjenë mue  
pertej caqeve t’harresës nepër botë.  
M’kishte marrë malli për ty  
dheu im!  
Të prita si motër e si vella  
kuvenduem, qeshëm e kjamë.  
Të putha si prind.  
Tokë e dheut pergjakun!  
Tokë pa grat, tokë me gurë  
Tokë e sertë dhe e veshtirë.  
Mjaltë i shpirtit tim.  
Dhë e baltë erë mirë.  
M’sollen një lule...  
Por Ah!  
Tash vegjton n’ballkonin e vendit huej...!

**BJERRJE**

Te shtrati milionavjeçarë Drini sonte fle vetëm.

Njerëzia u banë zogj shtegetarë dhe ikën.  
Erdh kjo ditë e u la me shi,  
erdh kjo natë e ushtoi si gjamë.  
Zani shekullor i lutjeve akuston nepër kishë  
tuj kndue alelun e lamtumirës  
e vorret rrisin selvijat  
me rranjë te fosfori i territ.  
Troja e bjerrun fle mbi dhë.  
Cili Homer ka me kndue Iliadën,  
cila Penelopë endë pelhurën e kthimit?  
N’fushë e n’mal  
toka shpallë ardhjen e dimnit  
e rrugët nën hanë, artere loti  
nderojnë karvanet n’ ikje  
me shpinë kah lindja e diellit.  
*nga Ndoc Selimi, Milano*

**LOTI I NANES**

Pse në mërzë nanës po i shkon moti.  
Pse mbi faqe i shkëlqen loti.  
Se i kujton femijët e vet.  
Qe i përkundi dikur në djep.  
As një herë se kish mendue .  
Femijët e vet për mej deshrue.  
Per merak kjo rritë i ka.  
Nëpër botë sot jan shpërnda.  
Kjo ja shton rrudhat e ballit.  
Kjo ja rritë ndjenjat e mallit.  
Kjo ja humbë gjumin e natës.  
Kjo ja afron ditët e plakjes.  
Kujton femijët me mbesa e nipa.  
Sa gjatë nanës i duket dita.  
Ditët e javës po i numron .  
Sa ngadalë koha po shkon.  
Mezi prët që të vijë vera.  
E ti shohë tuj ardhë te dera.  
E të rrijë me ta pak dit.  
Ta shkojë mallin për një vit.  
Amanet due me ju thanë.  
Kush ka lindë e ka thirrë nanë.  
Në dritë të diellit e në dritë të hanës.  
Ta kujtojnë zemrën e nanës.  
Cka don nana me shty motin.  
Don një dorë me ja fshijë lotin.  
Don një dorë me ngritë në kamë.  
Don një za për me i thirrë nanë.  
Ndue Vatnikaj, Prill, 2009.

**VARGJE PËR MËSUESIN**

(Në ditën e 7 marsit)  
Për Zotat që rrinë mbi re  
për më se dymijë vjet  
U flijuan miliona kope  
as gjë për mësuesin profet  
Më i vyeri profet lumnuës  
që njoh e kam pa me sy  
është apostulli i dashur mësues  
që botën ndriçoi me qiri  
Zoti dërgoi te ne shumë profet  
por as kush nuk beri kaq mrekulli  
Zoti e krijoi botën vërtetë  
por mësuesi e beri me sy  
*nga Prelë Milani*

**REDAKSIA**

Kryeredaktor: Luigj Shyti

Redaktorë: Lazër Stani, Roza Pjetri, Prelë Milani, Lazër Kodra,  
Suela Ndoja, Zef Nika, Zef Gjeta, Lulash Brigja

Mundësoi  
Botimin:  
**NDUE FTONI**

